



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Posaçëm për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.04.2018, ora 10.00

Drejtojnë mbledhjen:

Bledar Çuçi- kryetar Oerd Bylykbashi – kryetar

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Tryezë teknike “Fushata dhe rekomandime të tjera kyçe të OSBE/ODIHR-it”

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Gent Strazimiri, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Ermonela Felaj, Musa Ulqini, Enkelejd Alibeaj, Fatmir Mediu, Luan Rama, Vangjel Dule dhe Nard Ndoka.

Mungojnë:

Nasip Naço dhe Dashamir Shehi.

Të ftuar:

Ambasadori Bernd Borchardt, Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

Nicola Shmidt - eksperte e OSBE/ODIHR-it

Klement Zguri – Kryetar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Edlira Jorgaqi - anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vera Shtjefni - anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Bledar Skënderi - anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Gëzim Veleshnja – anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Illirjan Rusmali – Ekspert Zgjedhor

Gerta Meta – përfaqësues nga Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

Premto Gogo - përfaqësues nga Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

Rajmonda Prifti - përfaqësues nga Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

Mirela Arqimandriti - përfaqësues nga Koalicioni për Zgjedhje të Lira dhe Demokratike

Erida Skëndaj - përfaqësues nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Kristaq Kume - përfaqësues nga Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit Zgjedhor

Afrim Krasniqi - përfaqësues nga Instituti i Studimeve Politike

HAPET MBLEDHJA

Bledar Çuçi - Mirëmëngjesi të gjithëve!

Sot po zhvillojmë mbledhjen e radhës së komisionit *ad hock* për reformën zgjedhore. Një mbledhje e zakonë, në një vend të pazakonë për mbledhjet e komisionit, kjo për arsye, sepse ashtu sikurse të gjithë kemi rënë dakord me platformën që kemi miratuar për të adresuar dhe për të pasur një produkt sa më të plotë të komisionit për reformën zgjedhore, shumë nga mbledhjet, që nga dita e sotme do të jenë në formë *work-shop*-i ku do të ndërveprojmë me ekspertizën më të mirë që do të marrim kryesisht nga vendet e Europës, por jo vetëm. Sot është seanca e parë e radhës dhe shpresoj t'ia arrijë qëllimit për të cilin ne kemi menduar ta organizojmë në këtë formë.

Të dashur kolegë dhe të ftuar,

Ramë dakord dhe kemi marrë vendimin që punën tonë ta përqendrojmë në 6 shtylla kryesore për të adresuar, së pari, rekomandimet e OSBE-ODIHR-it për të tria zgjedhjet e fundit, zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013 dhe 2017 dhe zgjedhjet vendore të vitit 2015, si dhe për të adresuar problematika që vijnë nga këto zgjedhje, pikërisht të evidentuara nga partitë politike, nga aktorë të ndryshëm, që janë përfshirë në procesin zgjedhor, nga shoqëria civile, institucione që merren me administrimin zgjedhor. Këtë grupim, për të cilin ne e kemi marrë vendimin dhe kemi rënë dakord, nga pikëpamja metodologjike do ta trajtojmë sipas platformës.

Për kujtesë edhe të opinionit publik, 6 shtyllat kryesore janë:

1. Përdorimi i teknologjive të reja në procesin e votimit.
2. Adresimi për të bërë të mundur votimin e emigrantëve.
3. Çështjet që kanë të bëjnë me shitblerjen e votës.
4. Çështjet që kanë të bëjnë me fushatën dhe me ato që ne i quajmë rekomandimet kryesore të OSBE-ODIHR-it. Këtu kemi ndarë disa nënçështje, siç janë: fushata dhe media; financimi politik; burimet e shtetit.
5. Çështjet që kanë të bëjnë me regjistrin e votuesve dhe regjistrin civil, sepse, siç e dimë, regjistri i votuesve del si ekstrakt i regjistrit civil.
6. Administrata, duke e parë në këndvështrimin e përdorimit apo mospërdorimit të saj në procesin zgjedhor.

Nga pikëpamja metodologjike kemi rënë dakord që për secilën nga këto shtylla të bëjmë një proces të ndarë pak a shumë tek të gjitha, me 5 adresime. Për çdo çështje, gjëja e parë që do të bëjmë, kemi filluar me disa nga çështjet, është puna kërkimore, e cila do të rezultojë në një dokument të analizës së politikave dhe, pas kësaj, do të organizohet një tryezë apo *work shop*, pra një mbledhje e komisionit *ad hock*. Sot jemi te kjo pikë, konkretisht te çështja që ka të bëjë me financimin e partive politike, në pikën e tretë sipas metodologjisë që ka të bëjë me mbledhjen e komisionit *ad hock* në formë *work shop*-i, ku eksperti do të pasqyrojë punën kërkimore që ka bërë, do të paraqesë dokumentin e analizave dhe do të debatojmë, që më vonë të kalojmë te një raport me rekomandime nga tryeza e punës së sotme.

Së fundi, do të bëjmë diskutim përfundimtar në komisionin *ad hock* për të kaluar në procesin e draftimit të legjislacionit aty ku duhet ta ndryshojmë.

E bëra këtë panoramë për të vënë në kontekst takimin e sotëm se në çfarë faze të analizës të punës së komisionit *ad hock* jemi.

Sot në takim është i ftuar ambasadori Bernd Borchardt, i cili ka qenë vazhdimisht pranë, edhe prezenca e OSBE-së me asistencën e saj që do të vazhdojë të jetë, ashtu sikundër na janë bashkuar edhe organizma të tjerë, si: Këshilli i Europës apo partnerë të tjerë, të cilët kanë treguar interes për të financuar kryesisht punën e ekspertëve në komisionin *ad hock*, kështu që shpresoj që si eksperiencia e parë e kësaj forme të organizimit të komisionit *ad hock* për reformën zgjedhore, të jetë sa më frytdhënëse.

Nuk dua të zgjatem më në këtë pikë, që më tepër është procedurale, por dua t'ia kaloj fjalën bashkëkryetarit, zotit Bylykbashi, i cili mund të na fusë më konkretisht në çështjet që do të diskutojmë sot, si një kornizë e përgjithshme, dhe më pas, t'ia kalojë fjalën edhe zotit ambasador.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Përshëndetje, të nderuar kolegë, pjesëmarrës, të ftuar në këtë mbledhje të komisionit në formatin e një *work shop*-i teknik, siç e prezantoi zoti Çuçi, të fokusuar në tematikat e rëna dakord!

Së pari, do të doja të falënderoja ambasadorin Borchardt dhe prezencën e OSBE-së për ndihmën dhe asistencën në bashkorganizimin e këtij event!

Në kuadër të asistencës që po merr komisioni nga partnerët ndërkombëtarë, ku OSBE-ja luan një nga rolet kryesore bashkë me Këshillin e Europës, OSBE-ja ka rolin kryesor për

organizimin e kësaj tryeze, kështu që ju falënderoj edhe një herë, zoti ambasador! Gjithashtu, falënderoj OSBE-ODIHR-in, zonjën Nicola Shmidt që ka ardhur sot të prezantojë tematikat, problematikat e gjetura dhe rekomandimet që OSBE-ODHIR-i ka hasur gjatë tri palë zgjedhjeve të periudhave 2013-2015 dhe 2017, po ndoshta edhe më tej, për probleme ende të pazgjidhura në çështjet e fushatës, të cilat do të jenë fokusi i punës sonë bashkë me çështje të tjera, që të pranishmit, partitë politike apo institucione si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo shoqëria civile, kanë identifikuar gjatë gjithë kësaj kohe.

Unë besoj se ky lloj formati ndryshe i mbledhjeve të komisionit të reformës në formën e një *work shop*-i do të na ndihmojë që të ecim më tej.

Sigurisht, reforma zgjedhore është kryefjala e punës që bën jo thjesht ky komision, por edhe parlamenti gjatë gjithë kësaj periudhe.

Për sa i përket opozitës është një çështje prioriteti, e cila do të mbetet lart në axhendën tonë, por edhe të parlamentit shqiptar. Ajo që është shumë e rëndësishme, në kuadër edhe të procesit të hapjes së negociatave, është qartazi një tematikë thelbësore për të ndikuar në vendimmarrjen e Bashkimit Europian në lidhje me hapjen e negociatave, një moment jashtëzakonisht i rëndësishëm për Shqipërinë.

Siç e tha edhe zoti Çuçi, jemi në fillimin e zbatimit të planit të punës që ky komision ka miratuar me konsensus deri më sot në ato 6 pikat dhe në mënyrë të posaçme të çështja e fushatës. Fushata ka komponentë të ndryshëm siç janë: media, financimi, abuzimi me burimet njerëzore, por ka edhe problematika të tjera, tek të cilat do të fokusohemi sot. Të tilla janë: regjistrimi i kandidatëve, çështjet e fushatës që bëjnë partitë politike, kohëzgjatja dhe problematikat që dalin aty, çështje të cilat filluan të trajtoheshin para zgjedhjeve të vitit 2017. Pati ndryshime legislative të momentit të fundit, të cilat nuk u zbatuan plotësisht, siç ishte kufizimi i publicitetit në fushatën zgjedhore, problematika të tjera të lidhura me të, që unë shpresoj dhe uroj që do të dalin sot nga diskutimet e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të ekspertëve.

Gjithashtu, kemi probleme me një rëndësi thelbësore. Vërtet kemi një ligj për dekriminalizimin, por ndikimi i segmenteve kriminale edhe në fushatën zgjedhore, prezenca e tyre në mos nëpërmjet funksionesh shtetërore, por nëpërmjet funksionesh partiake, është një problem evident, i cili ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si bëhet fushata dhe në mënyrën se si e

perceptojnë zgjedhësit. Është sjellja e policisë, roli i saj për të balancuar jo vetëm për të garantuar mbarëvajtjen e fushatës, por edhe për të balancuar ndikimet negative që vijnë nga segmentet kriminale në fushatë. Ka çështje në lidhje me pjesëmarrjen e grave apo të minoriteteve, për të cilat OSBE/ODIHR-i ka rekomandime, por të gjithë ne kemi konstatuar problemet tona në periudhën e fushatës zgjedhore.

Ky është një model relativisht i ndryshëm nga mbledhjet, jo thjesht mbledhjet e komisionit, ato që ne dimë, por për një kohë shumë të gjatë në reformën zgjedhore. Mbledhjet e komisionit në formatin e këtij *work shop*-i teknik do të na japim mundësi për dy aspekte:

E para për të bërë atë që OSBE/ODIHR-i na ka rekomanduar në mënyrë shumë të mençur, që vendimmarrjet tona të jenë të bazuara në një vendimmarrje të informuar, pra të përcaktojmë pikat e politikës që do të ndjekim në trajtimin e këtyre çështjeve. Kjo mundëson që trajtimi të jenë përfshirës për sa i përket problematikës, por ky format na jep edhe mundësinë e inkluzivitetit, të përfshirjes, pra të mos jetë një diskutim i mbyllur vetëm në komision, por të jetë një diskutim, i cili përfshin institucionet kompetente, por mbi të gjitha shoqërinë civile, e cila ka një rol të jashtëzakonshëm në procesin e vëzhgimit, konstatimit si një zë i pavarur nga aktorët kryesorë, politikë apo institucional në problematikat që gjen dhe në qëllimin që ka për të garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Pra, duke shfrytëzuar këtë lloj forumi, uroj që sot të jetë një ditë e frytshme edhe si momenti i parë që hap një seri *work shop*-esh të komisionit të reformës zgjedhore, për të trajtuar tematika të tjera specifike. Sigurisht që do të ketë një *work shop* të veçantë për financimin, për medien, për shitblerjen e votës, për abuzimin me burimet shtetërore, të gjitha pjesë e fushatës, nuk janë të kufizuara si çështje, por sot do të përpiqemi të identifikojmë të gjitha çështjet e tjera, të cilat nuk do të kenë një event të posaçëm.

Pa u zgjatur më tej, po ia kaloj fjalën kreut të prezencës së OSBE-së, ambasadorit Bernd Borchardt, i cili do të na japë qëndrimin e prezencës në lidhje me këtë çështje.

Bernd Borchardt – Të nderuar bashkëkryetarë të komisionit parlamentar,

I nderuar kryetar i KQZ-së.

Zonja dhe zotërinj,

Miq,

Është kënaqësi që jam këtu me ju në këtë tryezë pune të parë së bashku me anëtarët e shoqërisë civile dhe me kolegen time Nicola Schmidt nga ODIHR-i në Varshavë. Aktiviteti i sotëm është i pari i një serie tryezash teknike që komisioni i posaçëm planifikon të organizojë për çështjen specifike të zgjedhjeve, e cila u përmend, por unë nuk po e përsëris.

Shpresoj shumë se mund të angazhohemi në këto tryeza pune, në diskutime të hollësishme, të cilat më pas do të na japin bazat për vendimmarrjet politike në komision dhe më vonë në Kuvend. Me koston e rënies në përsëritje, më lejoni t'ju theksoj sërish që ne rekomandojmë fuqimisht një reformë të bërë në kohë, një reformë të plotë, një reformë që do të merrte parasysh të gjitha rekomandimet e prapambetura të OSBE/ODIHR-it në zgjedhjet e 2013-ës, të 2015-ës dhe të 2017-ës.

Mandati i komisionit të posaçëm u zgjat së fundmi dhe rekomandoi fuqimisht që komisioni të finalizojë reformën zgjedhore brenda këtij afati të ri. Hapat përgatitore të ndërmarra nga komisionet deri tani, si: përcaktimi i objektivave, hartimi i kalendarit të punës, seancat dëgjimore me shoqërinë civile kanë qenë të lavdërueshme dhe tani është koha për gjëra konkrete dhe së bashku me OSBE/ODIHR-in ofrojmë mbështetjen tonë të plotë për parlamentin shqiptar për kryerjen e reformës. Një nga problematikat që është përmendur nga folësit përpara meje është çështja shitblerjes së votës. ODIHR-i rekomandon përpjekje të forta që nevojiten për të tatuar çështjen e vazhdueshme të blerjes së votës si nëpërmjet fushatës së përgjegjësimit, ndjekjes penale për të rritur besimin te procesi zgjedhor. Ne po i kushtojmë mjaft vëmendje çështjes së shkeljeve zgjedhore që i janë raportuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe po presim me padurim për më shumë dënime dhe vendime. E nxis fuqimisht komisionin e posaçëm dhe pjesëmarrësit e tjerë që të zhvillojnë një diskutim të hapur për territorin tuaj drejt rezultateve bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e ODIHR-it, si dhe në përvojën e gjerë që secili nga ju ka rreth këtyre çështjeve. Ka vendime shumë të rëndësishme që duhen marrë pa humbur kohë, pa zvarritje të mëtejshme dhe unë mezi pres të dëgjoj diskutimet gjatë kësaj dite. Pra, siç edhe jua thashë jemi të gatshëm të vazhdojmë të ofrojmë mbështetjen tonë për komisionin e posaçëm.

Ju falënderoj shumë për vëmendjen!

Bledar Çuçi - Shumë faleminderit, zoti ambasador, për përkrahjen pa rezerva të prezencës suaj për këtë komision, por edhe më gjerë!

Me mirëkuptimin edhe të gjithë kolegëve, të ftuarve dhe të përfaqësuesve të medias do të doja që mediet të largohen, sepse ky është një takim pune dhe duam ta mbajmë jashtë komenteve që dalin jashtë natyrës së punës.

Ju lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Komentet i bëjnë ata...

Fatmir Mediu – Më fal, në qoftë se jemi këtu për t'ju dëgjuar ju të dyve që bëni gjatë gjithë kohës referenca politike të reformës dhe ne të tjerët nuk kemi as zë në opinionin publik, as këtu, madje jemi të ftuar në *work shop*, mendoj se e keni gabim. Ne jemi komisioni i posaçëm i reformës zgjedhore dhe kemi mandat për të folur për reformën zgjedhore. Prandaj, do t'ju lutesha që medie të rrijë, sepse nuk ka asgjë, transparencë ndaj qytetarëve është më e rëndësishme.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Mediu!

Fatmir Mediu – Të paktën të na pyesni duhet apo nuk duhet të dalë medie.

Bledar Çuçi – Zoti Mediu, ju lutem, të flasim me radhë!

Faleminderit, zoti Mediu!

Në komision kemi bërë një marrëveshje ku çdo anëtar dhe përfaqësues i partive politike në komision mund të bëjë komentet e veta edhe pas mbledhjes së komisionit. Për të qenë strikt edhe me konkluzionet që do të nxjerrim në komision për çështje thellësisht teknike, kemi rënë dakord që media në këtë fazë të procesit mos ta kemi prezent në mbledhjet e komisionit.

Gjithsesi, ju jeni i lirë që pas mbledhjes së komisionit të bëni të gjitha deklaratat. Kjo është diçka për të cilën kemi rënë dakord dhe kemi bërë një marrëveshje paraprake.

Luan Rama – Më fal, zoti Çuçi! Kush ne, kemi rënë dakord ? Këtë vendim e merr komisioni.

Bledar Çuçi – Komisioni.

Luan Rama – Ne nuk jemi shprehur ende nëse kemi rënë dakord për këtë gjë, apo jo?

Pra, nëse do të duhet që medie të dalë jashtë, ky duhet të jetë një vendim unanim i komisionit ose...

Bledar Çuçi – Jam dakord...

Luan Rama - ... ose me votë në komision.

Bledar Çuçi – Jam dakord.

Luan Rama – Ju thatë në bazë të mirëkuptimit për të cilin ne kemi rënë dakord, por ne nuk kemi rënë dakord për këtë gjë. E para.

Bledar Çuçi – Kemi rënë në parim...

Luan Rama – E dyta, ju lutem, mos e shisni si një zbulim të madh këtë çështjen e *work shop*-it, nuk është ndonjë zbulim i madh. Ne jemi një komision që ende nuk kemi filluar nga puna me reformën zgjedhore. Deri tani kemi qenë komision dëgjimi, kemi dëgjuar çfarë kanë thënë përfaqësuesit NGO-ve, çfarë kanë thënë aktorë dhe faktorë të tjerë, por ne si komision nuk kemi filluar nga puna, ne si komision nuk kemi akoma asnjë produkt që lidhet me kodin zgjedhor. Nuk kemi vendosur se çfarë do të bëhet me çështjet themelore të kodit dhe mënyrën e trajtimit të sistemit, e të votimit. Jemi një vit para zgjedhjeve lokale, kur do t'i bëjmë ndryshimet dhe kur do të fillojmë të merremi me kodin për të nxjerrë një produkt që të na çojë në zgjedhje të ndryshme nga ato për të cilat ne referohemi. Akoma sot që flasim, shihni dosjen, i njëjti raport, zgjedhjet e 2013-ës, zgjedhjet e 2015-ës dhe zgjedhjet e 2017-ës. Ne i dimë rekomandimet, problemet, vërejtjet që ka bërë OSBE/ODIHR-i, por ne ende nuk kemi filluar të merremi me to. Ne po i bëjmë njëri tjetrit leksione dhe *work shop*-e për të mësuar se cili është standardi ku duhet të shkojmë.

Prandaj, ju lutem shumë, të jemi më seriozë dhe më transparentë në çdo vendimmarrje që merr komisioni! Ne jemi komisioni që duhet të marrë vendimin.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Një minutë, zoti Mediu.

Zoti Rama, pa diskutim që jemi një komision për të marrë vendime dhe prandaj kemi miratuar një kalendar për këtë gjë, të cilin e kemi miratuar të gjithë bashkë. Ne nuk po bëjmë gjë tjetër veçse po ndjekim kalendarin për të cilin kemi rënë dakord bashkë.

Kemi rënë dakord për metodologjinë dhe po ndjekim metodologjinë për të cilën kemi rënë dakord bashkë. Kjo besoj se ka qenë shumë e qartë që ditën që kemi miratuar këtë kalendar dhe këtë metodologji. Kemi rënë dakord që do të marrim ekspertizën më të mirë për ta lexuar jashtë syve të verbuar të politikës shqiptare në mënyrë që të kemi një pasqyrë sa më të pastër teknike për çdo çështje që do të adresojmë në komisionin për reformën zgjedhore në mënyrë që produkti, i cili mund të jetë në formë ndryshimesh ligjore, ndryshimesh rregullatore të tjera që nuk janë pjesë ligjore apo ndryshime në udhëzime, urdhra të institucioneve, të cilat janë

përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve të jenë sa më plotë dhe të paktën të arrijmë më në fund që pas zgjedhjeve të radhës të mos kemi të njëjtat rekomandime për të njëjtat çështje. Ne këtë e kemi diskutuar vazhdimisht në komision.

Pra, ne nuk po bëjmë gjë tjetër veçse po ndjekim axhendën për të cilën kemi rënë dakord. Nëse do të duhet ta shpejtojmë këtë axhendë, pa diskutim jam shumë dakord, kjo nuk varet vetëm nga ne, por varet edhe nga disponibiliteti i ekspertëve, të cilët do të përfshihen në këtë proces shumë të gjerë. Jo pa qëllim ju përmenda gjashtë fushat për të cilat ne kemi rënë dakord se si do të punojmë dhe hajdeni ta ndjekim axhendën. Unë nuk kam asnjë kundërshtim në lidhje me këtë gjë.

Sot është dita ku ne po marrim një pikë të axhendës dhe do ta ndjekim për ta çuar deri në fund dhe kështu mendoj se do të arrijmë në një produkt sa më të plotë, profesional dhe konsensual me shpresë të Zotit.

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull. Meqë kemi së bashku kryesimin, zoti Bylykbashi donte fjalën.

Oerd Bylykbashi – Siç e thamë, ky format nuk është përdorur 10 vjetët e fundit të reformës zgjedhore. Nuk është zbulim, të nderuar kolegë, sepse është bërë më herët, por, ky format i përgjigjet rekomandimit të parë të vitit 2017. Autoritetet duhet të ndërmarrin një reformë zgjedhore përfshirëse të zhvilluar në kohë dhe të mbështetur në analiza të plotë të politikave për trajtimin e rekomandimit të këtij raporti. Ky format synon pikërisht përfshirjen dhe diskutimin e gjerë të temave konkrete. Ky është një kalendar i miratuar. Ne mund të biem dakord ta përshpejtojmë mbi bazën e mundësive që kemi për ekspertizën dhe do të diskutojmë mbi bazën e kalendarit të miratuar nga ne si komision, ndaj është mbledhje, do të marrim vendime, do të diskutojmë edhe sot, do të arrijmë në konkluzione, do të bëjmë mbledhje standarde të komisionit për të marrë vendime për çështje të ndryshme dhe ekspertët do të ulen dhe do të draftojnë dispozitat e Kodit Zgjedhor mbi bazën e tyre.

Kjo është arsyeja pse sot jemi në diskutim dhe jo në draftim. Draftimi nuk është pjesë e këtij komisioni, do ta bëjnë ekspertët dhe ne do ta miratojmë më pas, por, me mirëkuptimin e të gjithëve, do të ecim me planin e punës së miratuar nga ky komision. Vendimmarrja e hershme e komisionit, që mbledhjet e punës janë të mbyllura, është për efektivitetin e punës sonë, por ndoshta në qëndrime në parim, që mund të kenë anëtarë të ndryshëm, pa hyrë në detajin e

diskutimit që do të bëjmë më pas, mund ta akomodojmë në minutat e para për të thënë pozicione parimi, por pa hyrë në detajin e çështjes, që do të jetë mbledhje formati pune jashtë fokusit të medies.

Zoti Mediu.

Fatmir Mediu – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Në fakt, thonë se për herë të parë berberi i ri e mëson dorën në kokën e fukarait dhe duket që pala andej ka një mision të mirë për qëndrimin që mbahet edhe për *work shop*-in, edhe për reformën zgjedhore. Duket që problemi është nga mirëkuptimi ynë.

Ju thoni se do të bëjmë një mbledhje të mbyllur dhe e hapur mbledhja është vetëm për ju dhe për zotin Çuçi, që e keni çdo takim për medien. Ne të tjerët, nëse gjejmë ndonjë kënd për të thënë ndonjë fjalë që kemi për mendimet dhe gjykimet për reformën zgjedhore, mund të na lejoni. Mendoj se kjo nuk ka sens. Nëse janë të hapura, janë të hapura. Nëse janë të mbyllura, janë të mbyllura, përfshirë edhe ju, sepse jeni bashkëkryetarë të komisionit, por pa mandat ekstra në pikëpamje të raportit me medien apo të vendimeve të këtij komisioni. Si parti politike, po, keni një raport tjetër. Mendoj se duhet të jemi transparentë dhe të hapur me medien, ose ta mbyllim për medien.

Problemi tjetër është se në mënyrë urgjente ky komision duhet të vendosë rregulloren e funksionimit të grupit të ekspertëve, të cilët janë në ajër, nuk merren me asgjë. Nuk dinë se çfarë bëjnë dhe nuk është hera e parë që ka komision të reformës zgjedhore në bashkëpunim me OSBE- ODIHR-in. Keni qenë edhe vet pjesëmarrës atëherë dhe besoj se ka funksionuar shumë herë më mirë se gjithë këta vjet, me përgjegjësi konkrete të grupit të ekspertëve dhe më pas me vendimmarrjen politike.

Nëse do të futemi në koncepte të reja, gjykime të reja, analiza, punë shkencore e të tjera, mendoj se reforma do të mbarojë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021, siç shkoi historia e reformës për zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, ku në momentet e fundit u katandisëm në disa amendamente që u bënë shpejt e shpejt, pa asnjë koncept që kishte të bënte me lirinë e zgjedhjeve.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Pala këtej është në një linjë të drejtë me vendimmarrjet e komisionit, që dy bashkëkryetarët e prezantuan këtu. Ne jemi këtu për të dëgjuar vërejtjet dhe sugjerimet e

ekspertëve që kanë ardhur për çështjen e radhës. Nëse ka pretendime nga parti të tjera, që duan të dalin para televizionit, mund të dalin, por nuk është çështje për t'u diskutuar në komisionet tona. Ne kemi një axhendë. Mund të kishit bërë vërejtje në fillim kundër programit të axhendës së sotme, që të fusnim në rendin e ditës një çështje tjetër dhe ta miratonim. Por ndërkohë që ne kemi filluar, ç'lidhje ka tani të themi se është çështja juaj e të tjera? Nëse është diçka teknike dhe ju thonë se nuk duhet të jenë mediet, të mos jenë. Nëse duhet të jenë patjetër, le të jenë mediet. Ne nuk e kemi problem, sepse thjesht do të dëgjojmë, do të mbajmë shënime dhe nuk do të bëjmë vendimmarrje. Vendimmarrjen do ta bëjmë kur të draftojmë një material përfundimtar.

Nëse nga krahu tjetër ka ndonjë material konkret për gjashtë pikat që tha Çuçi, të na i vënë në dispozicion, që ne të fillojmë diskutimin, meqë e kemi merak, por unë mendoj se diskutimet e komisionit për vendimmarrjet do të jenë në dy-tri mbledhjet e fundit. Ne do të marrim të gjitha idetë, mendimet dhe vërejtjet që janë bërë dhe, nëse ka materiale, do t'i marrim në fund. Nuk më duket korrekt debati që bëjmë tani pa filluar ende.

Fatmir, të jesh i qetë, sepse krahu këtej është në koherencë të plotë me vendimmarrjen e dy bashkëkryetarëve.

Luan Rama – Për ta korrigjuar qëndrimin, jam dakord, duke marrë shkas nga ajo që tha zoti Fino. Ne nuk jemi pala andej dhe pala këtej përballë reformës, por jemi një palë të gjithë së bashku në funksion të kurorëzimit të reformës, që të na çojë te standardi që kemi folur të gjithë ne, OSBE-ODIHR-i dhe partnerët ndërkombëtarë. Debati u hap nga fakti që të dy bashkëkryetarët këtu thanë se ne kemi vendosur që media të dalë jashtë. Nëse duhet ta vendosim që media të dalë jashtë, ta vendosim si komision, sepse është tagër i komisionit, e para.

E dyta, unë mund t'ju sjell këtu, por nuk dua të zgjatem, fjalimet që mbajtën dy bashkëkryetarët, duke i përjashtuar ato me fjalimet që kanë mbajtur në të gjitha mbledhjet e zhvilluara deri tani dhe janë mot a mot njësoj. Të njëjtën gjë thonë zoti Çuçi dhe zoti Bylykbashi. Problemi është që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni, por të thuash në 6 mbledhje të njëjtën gjë, do të thotë se ke xhiruar bosh.

Bashkim Fino – Po ia fut kot.

Luan Rama – Bashkim, më lejoni që unë t'ia fus kot dhe mbajeni ju të futurën plot. Problemi është se kur do të fillojmë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, ti je i kënaqur, unë jam i pakënaqur.

Unë nuk kam material në tavolinë, por ne kemi artikuluar qëndrimet parimore që kanë të bëjnë me defektet që ka shfaqur ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bashkim, mund të mbaroj?

Ne kemi qëndrime të njëjta parimore të shfaqura në 20 vjet që bëjmë reformë zgjedhore bashkë me OSBE-ODIHR-in dhe në 20 vjet vijmë tek të njëjtat probleme që shfaqin zgjedhjet, si: blerja e votës, manipulimi i zgjedhjeve, kontaminimi i zgjedhjeve dhe një produkt kriminal nga zgjedhjet. Ta zgjidhim këtë. Nëse e zgjidh *work shop*-i, jam dakord të vazhdojmë. Nëse e zgjidhim këtë duke nxjerrë medien jashtë, jam dakord ta nxjerrim dhe të vazhdojmë punën për të cilën jemi mandatuar. Kaq e thjeshtë është.

Bledar Çuçi – Ju falënderoj, zoti Fino, zoti Rama dhe zoti Mediu!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luan, ju lutem!

Ne kemi marrë një vendim përpara në parim dhe më vjen keq që ju e shtroni sërish çështjen sikur të mos jetë diskutuar. Megjithatë, është e drejta juaj.

Ne kemi rënë dakord në parim, që, kur vjen puna për të diskutuar për çështje thellësisht teknike, diskutojmë mes nesh dhe ekspertëve pa prezencën e medias, sepse kamerat përballë shtojnë zotin Mediu dhe ju të thoni sërish ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Mediu, ju lutem!

Unë ju dëgjova.

Kamerat ju shtojnë të kaloni në qëndrime politike pa u futur në thelb.

Për sa i përket pjesës së produktit dhe punës së komisionit, Luan, sot është dita që ne të fillojmë të shkruajmë produktin për një nga gjashtë çështjet. E përsërita në fillim, ramë dakord për një platformë me të cilën do të ngremë punën, kemi rënë dakord për një metodologji se si do të adresojmë gjërat dhe sot jemi në ditën ku bëjmë seancë dëgjimore, që të marrim kontribute edhe nga shoqëria civile për secilën nga çështjet, që janë mbajtur shënim, janë studiuar edhe nga ekspertët përkatës për këtë çështje dhe sot, për një ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni!

Fatmir Mediu – Nëse flisni kështu, nuk e dini.

Ekspertët nuk funksionojnë.

Bledar Çuçi – Zoti Mediu, ju lutem!

Janë marrë shënime nga ekspertët, të cilët janë të miratuar, janë pjesë e komisionit dhe secili bën punën e vet. Nëse eksperti juaj nuk ka dhënë kontribut, pa diskutim do të ketë kohë, sepse jemi të gjithë bashkë këtu dhe sot është dita për t'i thënë gjërat. Ditën që ne do të fillojmë punën konkrete dhe produktin që kemi si komision, ju doni të na i sillni sërish në

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Unë jam dakord që pa humbur kohë të fillojmë me punën e komisionit.

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Të nderuar kolegë,

Pa rënë në përsëritje, askush në këtë komision, mbi bazën e metodologjisë që kemi rënë dakord së bashku, nuk mund të fillojë të kontribuojë pa pasur një diskutim sa më të mirë dhe të shëndoshë në parim dhe në detaje, më pas për çështjet. Sot nuk ka më diskutime të përgjithshme, por diskutohet për çështjet e fushatës zgjedhore, për çështjet e financimit, për çështjet e medias, për abuzimin e pushtetit me shit-blerjen e votës, do të keni mbledhje si kjo të posaçme me ekspertë të posaçëm. Kjo është për të gjitha çështjet e tjera të fushatës që na shqetësojnë ne politikisht. Këtu kanë rast të flasin edhe politikanët, anëtarë të komisionit, edhe ekspertët e komisionit, ekspertë të pavarur apo shoqëria civile. Sot fillon në mënyrë konkrete. Deri më sot ka qenë në përgatitje. Siç është planifikuar dhe miratuar nga komisioni, javën e 16-ë të këtij viti organizohet kjo tryezë dhe jemi brenda shinave të kalendarit të punës. Fokusimi sot me çështje konkrete do të na japë mundësinë që sot të arrijmë në konkluzione si komision, me të cilën do të merren më pas ekspertët. Detyrat do t'ia japim ne, kurse ekspertët do të ulen të hartojnë. Për rrjedhojë, nëse ka hapësirë për të thënë ndonjë element tjetër në parim nga ana e kolegëve, pas kësaj, ne të fillojmë një punë konkrete dhe që nga ai moment komisioni do të vazhdojë punën e tij pa praninë e medieve, sepse diskutimet do të jenë të karakterit teknik dhe ndonjëherë edhe politik, por ne i përkasim këtij komisioni dhe duhet të arrijmë në konkluzione.

Fjala për ju, zoti Dule.

Vangjel Dule – Ju falënderoj të nderuar bashkëkryetarë!

Do ta konsideroj cinike shprehjen e zotit Çuçi, se kolegët u tunduan nga prania e medieve për të ngritur disa prej problematikave për të cilat po flasim. Është tepër cinike dhe e tepërt mes kolegëve, qoftë nga pozita e bashkëkryetarit, e kryetarit apo e kujtdo tjetër.

E dyta, besoj se qëllimi i *workshop*-eve, i axhendës është që të arrijmë produktin e reformës zgjedhore dhe nuk janë qëllim në vetvete as axhenda e as komisionet, pasi jemi në një auditor më të gjerë dhe duhet të pranojmë se jemi në pjesën e shtyrë të mandatit, domethënë pjesën normale të mandatit të Komisionit të Reformës Zgjedhore e kemi shpërdoruar pa arritur të hyjmë në thelbin e problematikave që duhet të trajtojmë. Pra, jemi në pjesën e dytë të mandatit, pasi është ripërtëritur me vendim të seancës plenare. Nuk mund ta pranoj këtë indiferentizëm ose prezantimin si normalitet, se ne kemi miratuar një axhendë ku në javën e 16-të do të bëjmë këtë gjë e në javën 23 do të bëjmë një gjë tjetër. Kemi dy palë komisione të reformës zgjedhore, të cilat kanë dështuar në të shkuarën, sepse mentaliteti përshkues dhe praktika e punës ka qenë e ngjashme me këtë, pavarësisht risive që mund të sjellin në formën teknike të organizimit të tyre. Kemi përpara çështje shumë të mëdha, për të cilat kemi rënë dakord t'i trajtojmë. Me këtë ritëm ju keni sigurinë se do të arrijmë të flasim për përfshirjen e teknologjive të reja në proceset zgjedhore, do të kemi një produkt vendimmarrjeje, do të miratohet në seancën plenare dhe do t'i nënshtrohet edhe fazave eksperimentale që kërkon, me qëllim që kjo të mund të aplikohet në ballafaqimet e ardhshme zgjedhore?

Kemi çështjen e votimit të emigrantëve, një fushë kaq e madhe dhe kaq e gjerë sa prapë jeni shumë optimistë, duke e ditur se pas dy muajsh përfundon sesioni parlamentar dhe se deri në muajin shtator duhet të kemi arritur ta konsumojmë si çështje, të kemi arritur konkluzione dhe vendime, si dhe të jemi gati për ta zbatuar! Ky është shqetësimi dhe jo prania e medieve, sepse nuk besoj se vuan kush për të parë fytyrën e vet në medie. Prandaj merreni mbrapsht këtë gjë dhe le ta shikojmë me seriozitet! Ne nuk kemi ardhur këtu si parlamentarë, që të kualifikohemi nëpërmjet seminaresh teknike dhe të bëhemi specialistë zgjedhesh, por kemi ardhur duke vlerësuar maksimalisht vlerësimet e specialistëve për të arritur në vendime sa më adekuate për reformën zgjedhore. Ka gjëra që duhen parë e riparë gjithmonë në funksion të misionit të këtij komisioni të reformës zgjedhore Mos harroni se nuk arritëm të bënim reformë zgjedhore dy herë!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Dule!

Jam plotësisht dakord me ju që ta zhbëjmë këtë realitet cinik dhe të ecim sipas axhendës, të cilën e kemi miratuar të gjithë bashkë. Nëse do të kishit gjëra në lidhje me axhendën, ky ishte moment tjetër për ta diskutuar. Ne kemi miratuar dhe sot nuk po bëjmë gjë tjetër përveç se po ndjekim agjendën që kemi miratuar. Kështu që ju ftoj me mirëkuptim që të vazhdojmë punën e komisionit në mënyrë që të jemi sa më produktivë!

Oerd Bylykbashi – Gjykoj që në këtë fazë të punës sonë, pa shtuar asgjë për atë që thashë, ashtu si unë edhe kolegët e tjerë, në mënyrë individuale, po edhe ekspertët, kanë për të thënë mendimet e tyre për çështjen e sotme. Për rrjedhojë sugjeroj që ta fillojmë prezantimin nga zonja Schmidt për gjetjet, problemet, rekomandimet që ka OSBE/ODIHR-i dhe, më pas, t'i bashkohemi ne me shqetësimet tona për një seri tematikash. Përmenda qëparë dekriminalizimin, i cili është në raportin e ODIHR-it, dhe që është shqetësim i madh i opozitës, apo roli i policisë. Këto janë çështje që do t'i ngremë të gjitha pa hyrë në diskutim në parim për to, por duke i trajtuar në mënyrë konkrete. Unë gjykoj që, tashmë shqetësimet për ecurinë e punës u ngritën dhe i ndaj ato shqetësime, por duke qenë se sot është dita e parë që fillojmë punën, ta fillojmë në mënyrë konkrete fillimisht duke falënderuar mediet për ndjekjen e punës së komisionit, pastaj duke vijuar me çështjet konkrete, që kemi për trajtim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është materiali me të cilin ne përballemi sot. Fatmir, të lutem, të jemi korrekt! Ky është plani dhe kalendari i punës, që ekspertët i kanë, sot fillojmë me diskutimin e çështjeve, ekspertët kanë për të thënë dhe mbajtur shënime, nuk mund të vijnë sot me drafte, sepse ne do të dëgjojnë. Për rrjedhojë le t'i zgjidhim të gjitha problemet që kemi sot! Ky është moduli për të cilin kemi rënë dakord, përndryshe të gjitha këto çështje nuk mbarojnë dot. Ne si opozitë kemi interes të ecim shpejt dhe uroj që edhe maxhoranca të ketë të njëjtin merak, pra, të ndjekim axhendën që kemi përcaktuar. Nëse e ndryshojmë, do të humbasim kohë. Unë besoj se janë çështje të diskutuara dhe të zgjidhura, kështu që, siç e lamë, le të fillojmë nga puna!

E ftoj, zonjën Schmidt që të na bëjë prezantimin, duke e falënderuar edhe një herë për gatishmërinë për të ardhur në të gjitha mbledhjet e komisionit!

Fjala për ju, zonja Schmidt.

Nicola Schmidt – Faleminderit dhe mirëmëngjesi!

Çfarë nisme interesante! Shpresoj që do të vazhdojmë të diskutojmë në të njëjtën mënyrë gjatë ditës! Kam përgatitur disa dokumente në lidhje me temat e sotme. Jam shumë e lumtur që jam këtu sot dhe që mbështes këtë proces të komisionit të posaçëm! Shpresoj që unë dhe kolegët e mi të jemi të dobishëm për ju në këtë kuadër! Siç kanë shpjeguar bashkëkryetarët, komisioni ka vendosur të ndajë punën në tema të ndryshme dhe për t'i trajtuar ato individualisht, si dhe për të vijuar në këto aspekte. Unë do të flas për rekomandimet e ODIHR-it, por si bashkëkryetarë, edhe ju mund të bëni rekomandime të tjera. Patjetër që mund të ketë rekomandime nga partitë politike, nga shoqëria civile dhe nga KQZ-ja. Shumë nga rekomandimet e ODIHR-it, që kanë të bëjnë me fushatën bien në fusha që kanë interes për ju. Fushat do të diskutohen në një hap të mëvonshëm, por sot ne do të përqendrohemi te fushata dhe te rekomandimet e tjera kyçe, prandaj kemi përfshirë rekomandimet nga 4 raporte për diskutimin e sotëm, duke filluar nga zgjedhjet vendore të vitit 2011 dhe duke vijuar me ato të vitit 2015, pastaj me zgjedhjet parlamentare 2013-2017. Në materialet tuaja ju keni një listë që ne kemi përgatitur me të gjitha rekomandimet, me tekstin e rekomandimeve, me fushat ku përkojnë këto rekomandime, kemi përfshirë disa nga standardet ku bazohen, që mund të jenë të dobishme për diskutim. Gjithashtu, kemi përfshirë edhe mendimet tona, pra të ODIHR-it për faktin nëse këto janë çështje që kërkojnë ndryshime ligjore apo bëhet fjalë për ndryshimin e zbatimit të procesit të zgjedhjeve. Shpresojmë që kjo të jetë e dobishme për ju!

Do të them dy gjëra në fillim kur flasim për rekomandimet. ODIHR-i ka përmendur shpesh reformën zgjedhore si diçka të rëndësishme, që të jetë gjithëpërfshirëse, të bëhet në kohën e duhur dhe të bazohet në analiza politike. Mendoj se puna e komisionit është që të bëjë hap përpara në këtë drejtim për të trajtuar rekomandimet. E kuptoj që të gjitha duam të ecim me hap më të shpejtë, apo të bëjmë më shumë diskutime. Edhe nëse është fillim, është fillim i mirë, të paktën nga pikëpamja jonë.

Një rekomandim tjetër i rëndësishëm i përsëritur nga ODIHR-i në të gjitha zgjedhjet e mëparshme, ka të bëjë me kryerjen profesionale të detyrave nga kushdo që është i përfshirë në këtë proces, si partitë, listat zgjedhore dhe aktorë të tjerë, si shoqëria civile apo përfaqësues të shteteve të tjera. Mendoj se kjo është një çështje e rëndësishme, por, me sa kuptoj nga planet e komisionit, kjo do të diskutohet në një fazë të mëvonshme, veçanërisht kur flasim për administratën zgjedhore. Kjo ka të bëjë me të gjitha fushat e zgjedhjeve, gjithashtu, ka edhe

rekomandime të bëra nga ODIHR-i, të cilat do të doja t'i përmendja, sepse janë të rëndësishme në lidhje me fshehtësinë e votës dhe ka të bëjë me dizajnin e fletës së votimit. Ekziston mundësia që votuesi të lidhet me fletën e votimit për arsye të mënyrës si është dizenuar fleta e votimit. Thjesht doja ta përmendja këtu në mënyrë që të merret parasysh, por sot qëllimi kryesor do të jetë regjistrimi i kandidatëve, pjesëmarrja e grave dhe e minoriteteve kombëtare për çështjet e ankesave, si dhe në lidhje me rregullat e bërjes së fushatës, ndërsa për medien dhe financimet politike do të diskutojmë në takimet e tjera të radhës.

Pra, së pari, dua të them disa fjalë rreth regjistrimit të kandidatëve për zgjedhjet që ka vëzhguar ODIHR-i. Ne kemi thënë që regjistrimi ka qenë përgjithësisht përfshirës dhe ka pasur mjaft kandidatë, por ndonjëherë ka pasur interpretim shumë të kufizuar dhe zbatim jo njësoj të rregullave. Kjo ka çuar në rekomandimet e ODIHR-it në këtë kuadër. Ka 7 rekomandime, të cilat përfshijnë dy rekomandime për përkrahjen e më shumë grave kandidate në zgjedhje. Ka rekomandime që përfshihen në dokumentin që është zbatuar që nga viti 2011, por me sa kuptoj ju mbështeteni kryesisht te çdo gjë që vjen nga 2013-a e poshtë. Pra, rekomandimet tona kishin të bënin me afatet ligjore që duhen harmonizuar me afatet praktike, në mënyrë që çështjet që duhen ndërmarrë, si, për shembull, printimi i fletëve, duhet të bëhet vetëm pasi të gjitha afatet e tjera ligjore të jenë respektuar për regjistrimin e kandidatëve dhe kjo përfshin, gjithashtu, ankesat e mundshme rreth regjistrimit të kandidatëve. Kemi thënë që duhet të ketë rregulla të qarta dhe që duhet të zbatohen në mënyrë të qëndrueshme, duhet të zbatohen njësoj. Për këto rregulla duhet të ketë siguri për gjithë ata që marrin pjesë në zgjedhje. Të gjitha vendimet duhet të ndërmerren përpara nisjes së fushatës, në mënyrë që kandidatët të bëjnë fushatë në mënyrë të barabartë. Nëse ka ankesa ose një kandidat regjistrohet më vonë, ose tërheq regjistrimin më vonë, atëherë duhet të ketë ndryshim në listën e kandidatatëve.

Ne, gjithashtu, rekomanduam që aktorët zgjedhorë mund të përfshihen në vëzhgimin e procesit të verifikimit të firmave. Në zgjedhjet e mëparshme kemi parë që ka pasur disa problematika nga kandidatët që nuk kishin mundësi të bënin monitorim, nuk mund të ndiqnin plotësisht procesin. Pra, kemi rekomanduar që një gjë e tillë të bëhej.

Kur flasim për regjistrimin e kandidatëve ka standarde ku i bazojmë rekomandimet tona dhe mendoj se këto mund të ndihmojnë për të udhëhequr procesin tuaj. Patjetër që është e drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur, angazhimet për votimin universal, të drejtën e votës, që

mendoj se në Shqipëri përgjithësisht janë të zbatueshme dhe të zbatuara. Pra, keni shumë diapazon të gjerë kandidatësh, ka fushë të gjerë kandidatësh, por më shumë ka të bëjë me mënyrën se si zbatohen rregullat praktike. Këto janë çështje që duhen parë në Shqipëri për regjistrimin e kandidatëve. Ka të bëjë me garimin që kandidatët duhet të kenë të drejtën për garim të barabartë. Pra, të nisen nga e njëjta pikë nisjeje për të bërë fushatë, që të kenë mundësi të bëjnë ankesë ndaj çështjeve të caktuara dhe të ankohen rreth vendimeve të caktuara dhe që kufizimet se kush mund të jetë kandidat duhet të jenë të arsyeshme. Ne nuk kemi parë probleme të rënda në kufizimet për kandidim. Ka pasur disa raste në zgjedhjet e fundit ku disa kandidatë janë regjistruar në një afat kohor më të vonë, kurse disa nuk u regjistruan, por ne i kemi parë këtë si një zbatim jo njësoj të rregullave ekzistuese.

Ekzistojnë disa gjëra për t'u marrë parasysh nga Komisioni i Venecias. Janë disa gjëra praktike kur bëhet fjalë për procesin si, për shembull, kontrollin e firmave që duhet të ketë rregulla të qarta, që duhet të ketë transparencë, duhet të gëzojë të drejta për ankesë, e kështu me radhë.

U përpoqa të gjej disa shembuj në lidhje me të gjitha shqetësimet tona.

Kur shoh në regjistrimin e kandidatëve, rregullat që ju keni në Shqipëri janë shumë të ngjashme me rregullat e shteteve të tjera, në lidhje me firmat, kërkesat për firmat, depozitimin e dokumenteve, dorëzimin e dokumenteve të KQZ-ja, e kështu me radhë. Për shembull, në Bosnjë Hercegovinë ekziston një depozitë monetare që duhet paguar dhe që partitë, apo kandidatët, që nuk përfaqësohen në parlament, për këto janë. Ata do të mbledhin firmat. KQZ-ja atje verifikon dokumentet dhe firmat. Mund të jetë diçka interesante që në Bosnjë ka një ligj për konfliktin e interesit, ku kandidatët duhet të japin informacione rreth gjendjes së tyre financiare dhe të ardhurave, dhe kjo duhet kontrolluar, nëse ekziston ndonjë konflikt interesi në punën e tyre, apo në pozicionin që kanë, gjë që do të ndikonte në punën e tyre si anëtarë të parlamentit. Në Malin e Zi, për shembull, kërkohet gjithashtu, të ketë firma që do të jetë 0,8% e votuesve për kandidatët që përfaqësojnë pakicat kombëtare kërkesa është 1 mijë firma dhe për pakica edhe më të vogla ata duhet të kenë 300 firma dhe këtë do të verifikonte KQZ-ja. Pra, me këtë kërkesë për firma që ka Shqipëria është pak e ngjashme me vende të tjera si me Gjermaninë. Unë jam vetë nga Gjermania dhe po përpiqem të fus shembull nga Gjermania. Ekziston një rregull në ligj. Kandidatët duhet të përzgjidhen nga zgjedhje të brendshme të partive dhe një gjë e tillë duhet

dokumentuar kur dorëzohen letrat e regjistrimit të kandidatëve. Partitë joparlamentare, kandidatët joparlamentarë duhet të dorëzojnë edhe firma mbështetëse. Unë mendoj se kjo tregon që ka mënyra të ndryshme për ta trajtuar çështjen e firmave, ama ka edhe ngjashmëri. Është e rëndësishme që procesi të jetë gjithëpërfshirës, që kandidatët të regjistrohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, që votuesit të kenë zgjedhje dhe të ketë transparencë në këtë proces. Pra, ata që duan të jenë kandidatë, ata që janë kandidatë në fund të procesit, ta dinë se cilët janë procedurat, të kenë afate të qarta dhe t'u binden këtyre afateve, t'i respektojnë, sepse nëse dorëzohen dokumentet me vonesë, sipas pikëpamjes sime, nuk duhet të ketë pritshmëri që dikush mund të regjistrohet si kandidat nëse nuk kap afatin, nëse afati përcaktohet qartë nga ligji dhe duhet lënë edhe koha në dispozicion që të ketë kohë për ankesa për këtë proces. Mund të flasim më vonë për këto çështje, nëse dëshironi.

Ndërsa rekomandimet e tjera, që kanë përfshirë diskutimin tonë të sotëm është pjesëmarrja e grave, që është diçka me interes për ODIHR-in, gjatë monitorimit të zgjedhjeve. Ajo që ka vënë re ODIHR-i në zgjedhjet e mëparshme është që në përgjithësi gratë përfaqësohen më pak në administratën zgjedhore. Gratë përbëjnë 1/3-n ose më pak të anëtarëve të KQZ-së ose të administratës zgjedhore në përgjithësi. Nuk janë kandidatë aq shumë në numër nëpër listat e partive. Duke parë raportin, ka pasur respektim më të mirë të kuotës gjinore në 2015-n, por edhe kërkesat për zgjedhjet vendore janë më të forta ose më të ashpra sesa ato të zgjedhjeve të përgjithshme. Në zgjedhjet parlamentare duhet që 1 nga 3 të parët të jetë grua, kurse për zgjedhjet vendore 1 në 3 duhet të jetë grua. Pra, kërkesat janë më të ashpra në listat e zgjedhjeve vendore. Ka sanksione të parashikuara në legjislacionin tuaj dhe disa nga këto sanksione, kur nuk zbatohet kuota gjinore... Në fakt, janë zbatuar, por ato nuk janë zbatuar njësoj, në mënyrë të qëndrueshme. Pra, ka pasur raste që disa parti do të paguanin gjobë, kurse parti të tjera nuk do ta paguanin atë gjobë. Pra, ODIHR-i ka bërë rekomandime për mënyrën ose për çfarë mund të bëhet për ta përmirësuar këtë situatë dhe patjetër që një nga rekomandimet e ODIHR-it, siç ndodh shpesh me ODIHR-in, sepse është rekomandim i përgjithshëm, është përkrahja e mëtejshme e grave kandidatë për të bërë diçka lidhur me këtë gjë. Si mund të bëhet kjo? Mund të vendosim më shumë sanksione për mospërputhje me ligjin për kuotat gjinore, gjoba mund të jetë më e lartë apo refuzimi i listës, apo KQZ-ja mund të thotë që partia duhet të përmirësojë listën përpara se të pranohet. Pra, mund të merrni parasysh forcimin e kërkesës së kuotës dhe masave të

veçanta si, për shembull, të kërkonin që të jetë një grua, një burrë, në çdo listë në mënyrë të alternuar njëra pas tjetrës dhe të mund të merrni parasysh caktimin e një kuote për nivelet më të ulëta të administrimit të komisioneve zgjedhore, ose në të gjithë administratën zgjedhore. Pra, ka disa gjëra që mund të bëhen për të përkrahur më shumë përfaqësi gjinore, sidomos kur bëhet fjalë në pozicione vendimmarrëse. Kjo mbulohet, gjithashtu, nga standardet kryesisht Konventa e OKB-së për eliminimin e diskriminimit kundër grave, që ofron në mënyrë të qartë mundësinë për të marrë masa të caktuara siç janë dhe vetë kuotat.

Angazhimet e OSBE-së, gjithashtu, kërkojnë barazi të burrave dhe grave dhe kërkesat e përgjithshme të së drejtës universale të votës, që zbatohen, gjithashtu, për gratë dhe për burrat. Për shembull, në Kroaci kam parë që ekziston një kërkesë minimale 40% për secilën gjini nga listat e partive. Dhe ata duhet paguajnë një gjobë prej rreth 6600 eurosh nëse nuk përputhen. Personalisht mendoj se kjo është shumë gjobë e ulët, sepse po ta shihni, për mospërmbushjen e këtyre kërkesave në Kroaci ajo ka nivel shumë të lartë. Rreth ¼-a e listave të partive nuk përputhen me kërkesat. Nuk e kanë problem fare të paguajnë gjobën dhe pastaj regjistrojnë listat e tyre. Në Mal të Zi minimumi është 30% që kërkohet për secilën gjini ose për gjininë më pak të përfaqësuar, plus një person të kësaj gjinie për çdo 4 pozicione në listë. Në Gjermani nuk ka kërkesa ligjore, nuk ka kuota sipas ligjit, por disa parti kanë krijuar kuotat e tyre të brendshme. Për shembull, një në dy emra të jetë nga secila gjini. Pra, bën një alternativim. Ky quhet sistemi *Zipper*. Një burrë, një grua e kështu me radhë.

ODIHR-i, gjithashtu, monitoron pjesëmarrjen e minoriteteve kombëtare. Në lidhje me zgjedhjet e shkuara shumica e rekomandimeve kishin të bënë me komunitetin rom dhe egjiptian në Shqipëri. Duhet bërë më shumë përpjekje për të siguruar pjesëmarrjen e efektshme të komunitetit rom. Ajo që ka vënë re ODIHR-i, në fakt, nxit pjesëmarrjen e pakicave kombëtare. Ka ndodhur një farë nxitjeje për këtë. Ekziston mundësia për materiale edhe në gjuhën e pakicave. Ka pastaj edhe edukim votuesish që synojnë pikërisht minoritetet. Është vënë re që këto komunitete janë të cënueshme në lidhje me çështjet e shitblerjes së votës, por rekomandohet që ata të marrin më shumë programe edukimi për votuesit, që duhet përshtatur për këto të komuniteteve rom dhe egjiptiane, pikërisht për të trajtuar çështjen e shitblerjes së votës.

Gjithashtu ekzistojnë standarde që bazohen në rekomandime.

Është konventa ndërkombëtare, por edhe ajo civile dhe politike, që thotë se të drejtat duhen garantuar pa asnjë lloj dallimi dhe pastaj janë angazhimet e OSBE-së, që të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se personat që janë pjesë e pakicave kombëtare, kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtat e tyre pa diskriminim.

Pra, u kam hedhur një sy shumë vendeve të tjera dhe më duhet t'ju them se nuk gjeta ndonjë shembull të programit të efektshëm të edukimit të votuesit, që përqendrohet te komunitetet rome apo te komunitetet e tjera dhe mendoj se në këtë rast Shqipëria mund të shërbejë si shembull dhe mund të ndërtojë mbi këtë dhe ta zgjerojë këtë çështje.

Kam parë disa vende që ofrojnë informim të votuesve në gjuhë të ndryshme. Sidomos në SHBA një gjë e tillë është pjesë e legjislacionit. Është kërkesë ligjore që informacioni i votuesve duhet të vihet në dispozicion dhe fleta e votimit duhet të ofrojë disa gjuhë të ndryshme, në varësi se cilat minoritete dhe cilat komunitete jetojnë në zona të caktuara. Mund të jetë komuniteti spanjoll, mund të jetë komunitet tjetër, që përdor gjuhën e filipinasve, mund të jetë korean, kinez e kështu me radhë, në varësi të zonës.

Dua të them disa gjëra në lidhje me rregullat e fushatës.

Siç e thashë më parë, shumica e komunikimeve tona për fushatën, kanë të bëjnë me fushën e medias dhe financimin e partive politike, gjithashtu, në lidhje me luftën ndaj shitblerjes së votave dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore dhe eliminimin e presioneve ndaj votuesve.

Për një gjë të tillë do të diskutojmë në një fazë tjetër.

Dua të përmend se kemi përfshirë rekomandimet për këto çështje. Kam parë disa çështje të tjera në lidhje me fushatën, veçanërisht, me atë që kam parë vitin e shkuar, për shembull, periudha e fushatës dhe vendosja e posterave apo reklamave të mëdha.

Periudha zyrtare zgjedhore në Shqipëri ishte 30 ditë, deri në 24 orë përpara ditës së zgjedhjeve dhe, siç u ra dakord, vjet, në fakt, u kufizua prania e posterave të mëdha, banderave apo flamurëve, sepse u ra dakord se gjëra të tilla duhet të vendosen vetëm kur janë në afërsi të zyrave të partive. Kohëzgjatja e fushatës me 30 ditë, pastaj një periudhë heshtjeje 24 orë përpara zgjedhjeve, ndodh edhe në vende të tjera, për shembull, në Bosnjë apo në Bullgari. Në disa vende kjo periudhë është më e shkurtër. Për shembull, në Kroaci, në zgjedhjet e fundit fushatat ishin vetëm 17 ditë. Në Malin e Zi nuk ekziston asnjë dispozitë në legjislacion në lidhje me kohëzgjatjen e fushatës zgjedhore. Në Gjermani nuk ekziston asnjë periudhë zyrtare zgjedhore.

Partitë mund të bëjnë gjithë kohës fushatë teorikisht, ama ato fillojnë ta bëjnë një gjë të tillë vetëm pasi është finalizuar regjistrimi për zgjedhjet e radhës.

Në lidhje me posterat, shumë pak shkruhet në legjislacion, për vendet se ku do të vendosen dhe mënyrën si duhen vendosur.

Një gjë interesante, në Gjermani, për shembull, është që hollësitë rreth posterave, bandierave dhe gjërave të tilla, rregullohen nga autoritet bashkiake. Nuk rekomandoj që kjo të bëhet në Shqipëri. Disa shtete të Gjermanisë, sepse ju e dini që kemi shtete federale dhe jofederale, kemi 16 shtete të ndryshme dhe në disa shtete, si parti duhet të qasen 400 autoritete për të rënë dakord se ku do të vendosen posterat. Shqipëria është me vogël se Gjermania, por prapëseprapë mund të mos jetë gjë e kollajshme që të takohesh dhe të biesh dakord me kaq shumë autoritete.

Kur flasim për periudhën e heshtjes zgjedhore, përgjithësisht është praktikë e mirë që të ketë një periudhë heshtjeje, qoftë një apo dy ditë para ditës së zgjedhjeve, sepse ka vende që e kanë edhe dy ditë, siç është rasti i Serbisë, që u jepet kohë votuesve për të reflektuar rreth zgjedhjes që do të bëjnë.

Përsëri mendoj se është e rëndësishme për fushatën që të ketë barazi për kandidatët, që të kenë qasje të barabartë për të bërë fushatë dhe të kenë qasje në vende të caktuara ku do të bëjnë fushatën, të trajtohen në mënyrë të barabartë nga ligji dhe autoritetet dhe të ekzistojnë dispozita të qarta dhe rregulla të qarta, lidhur me vendosjen e posterave dhe në lidhje me çështjet e tjera, që kanë të bëjnë me fushatën. Pra, mund të mendohet, nëse do të caktohet një vend ku do të vendosen posterat (të lejohen vetëm në një vend të caktuar, të ketë disa vende të caktuara ku të lejohen), mënyra si do ta trajtoni, reklamat, pra ku partitë të blejnë një vend të caktuar, të marrin me qira një vend të caktuar, ku të vendosin reklamat apo të blejnë një afat kohor nëpër medie? Pra, diçka që ju duhet ta mendoni dhe ta merrni parasysh, duke pasur parasysh sidomos parimet e barazisë në lidhje me qasjen e barabartë. Patjetër që kjo ka ndikim në financimin politik.

Për financimin e partive politike do të flasim në një hap tjetër.

Kolegu im Aleksei pretendoi të ishte këtu dhe të fliste për ankesat, por fatkeqësisht Austrian Airlines nuk e priti në Vjenë. Kështu që ai ndodhet ende në Vjenë, duke pritur të kthehet në Varshavë. Unë i thashë se do të flas në lidhje me ankesat dhe kërkoj ndjesë nëse nuk jam shumë e qartë për këtë pjesë, por edhe mund ta diskutojmë më vonë!

Ankesat kanë qenë problem, në fakt. Po ta keni vënë re, në rekomandimet e mëparshme të ODHIR-it, ka shumë rekomandime të bëra në lidhje me proceset dhe sidomos me strukturën e proceseve të ankesave në Shqipëri, që nga viti 2011. Po të shohim 3 raportet e fundit, ka shumë gjëra që thuhet sipas OSBE/ODIHR që do të bëhen në lidhje me ankesat.

Një nga këto rekomandime ka të bëjë me bërjen e një shqyrtimi të plotë lidhur me strukturën e ankesave, për të menduar se procesi do të bëhet më i qëndrueshëm, të jetë njësoj dhe të jetë më i qartë dhe më i thjeshtë. Është proces mjaft i ndërlikuar, që ekziston në Shqipëri, në lidhje me se kush merret me ankesat.

Çështja tjetër është se garancitë duhet të ekzistojnë, duhet të jenë të efektshme, që të ketë trajtim të bërë në kohë dhe të efektshëm të ankesave. Në Shqipëri nuk është fiks ky rasti, ku e drejta për ankesa është e kufizuar për disa aktorë të caktuar zgjedhorë, por nuk i lejohet ankesa votuesit individual.

Kur bëhet fjalë për fushatën dhe strukturën e ankesave, ndonjëherë afatet janë shumë të gjata, sidomos në periudhën para zgjedhjeve, që do thotë deri në 10 ditë.

Kur behët fjalë se sa kohë ka në dispozicion Kolegji Zgjedhor për të trajtuar ankesat, një gjë e tillë shihet si një kohë shumë e gjatë ... dhe nga praktikatat ndërkombëtare.

Mendoj se duhet të ulet ky numër ditësh dhe duhet të jetë rreth 5 ditë, jo 10, për t'i dhënë mundësi dikujt që ankohet, që të ketë mundësi të apelojë vendimin e marrë dhe në mënyrë që Kolegji Zgjedhor të ketë mundësi të japë vendim para ditës së zgjedhjes ose përpara se të përfundojë regjistrimi i kandidatëve apo elementeve të tilla. Pra, ka të bëjë me kohën, në mënyrë që fushata zgjedhore të vazhdojë normalisht.

Gjithashtu, duhet të ekzistojë mundësia për të bërë apel në gjykatë për të gjitha vendimet e marra në lidhje me ankesat.

KQZ-ja miraton rezultatet dhe ky vendim mund të apelohe vetëm te KQZ-ja, por jo te Kolegji Zgjedhor. Angazhimet ndërkombëtare, në fakt, kërkojnë të drejtën për apelim gjyqësor për të gjitha vendimet administrative që ndërmerren. Pra, kjo është diçka që mund të merret parasysh, që aspektet kryesore të procesit zgjedhor duhet të jenë të apelueshme në një organ gjyqësor dhe, gjithashtu, duke marrë parasysh se vendimi i Kolegjit Zgjedhor duhet të jetë i apelueshëm, duhet të ekzistojë gjithmonë e drejta për të apeluar edhe një vendim gjyqësor.

Përmenda, gjithashtu, shkurtimin e afateve kohore, që të ketë më shumë transparencë, duke kërkuar botimin e të gjitha vendimeve të KQZ-së dhe të Kolegjit Zgjedhor. E kuptoj se botimi i vendimeve të KQZ-së kërkohet, në fakt, nga legjislacioni, por nuk e kam shumë idenë, nuk jam shumë e qartë (mbase mund të më ndihmoni ju), nëse vendimet e Kolegjit duhet të transkriptohen, të zbardhen dhe të botohen, por ODHIR-i ka vënë re se nuk botohen gjithmonë, sidomos brenda afateve kohore, të cilat kërkohen nga legjislacioni. Botimi i vendimeve do të ndihmonte të kuptohej pse është marrë një vendim i caktuar dhe pse duhet të vazhdojë dhe si duhet të vazhdojë procesi.

Ekzistojnë disa çështje ose probleme, që disa fusha të legjislacionit për bërjen e fushatave zgjedhore nuk janë të rregulluara në lidhje me ankesat, sidomos kur bëhet fjalë për ankesat para zgjedhjeve, se cilët merren me këtë, merren KZAZ-të, KQZ-ja? Pra, një gjë e tillë duhet sqaruar.

Pastaj kam një rekomandim të bërë nga ODHIR-i, që nuk është rekomandim ligjor, por është rekomandim praktik dhe në lidhje me zbatimin. Ka të bëjë me trajtimin formalist të ankesave.

Në disa raste, ODHIR-i ka vënë re se KQZ-ja dhe Kolegji janë treguar shumë formalë, shumë zyrtarë. Formaliteti nuk është edhe aq shumë problem në përgjithësi, por kur çon në mungesë të një zgjidhjeje të saktë të ankesave, kthehet në problem. Rekomandimi është që ky trajtim formalist, le të themi, i ankesave, duhet shmangur.

Diçka tjetër që ODHIR-i ka vënë re është se vendimet në lidhje me ankesat shpesh lidhen me pozicionin politik të personave në komisione zgjedhore apo në Kolegjin Zgjedhor dhe kjo ka të bëjë me... Duhet marrë parasysh se vendimet nuk duhet të bazohen në pikëpamje politike, por duhet të bazohen në ligj, në atë që shkruhet në ligj, jo në pikëpamjen politike të anëtareve të kolegjit.

Kaq në lidhje me ankesat.

Kam përfshirë diçka edhe për standardet, që të shikoni se kjo që po them bazohet në standardet ndërkombëtare.

Standardet kërkojnë për zgjedhje të efektshme dhe e efektshmja nënkupton edhe në kohë dhe kërkon zgjidhje të efektshme për të gjithë. Kjo gjë do të vlejë për votuesit, do të vlejë

për të gjithë. Kërkoet shqyrtim gjyqësor dhe kërkoet informacion në lidhje me zgjidhjet dhe vendimet që vihen në dispozicion publikisht.

Përsëri Komisioni i Venecias tregohet shumë specifik dhe thotë se duhet të ketë afat të shkurtër kohor për ankesat dhe rekomandon 3-5 ditë.

Kërkoj ndjesë se nuk kanë marrë shembull nga shtetet e ndryshme për këtë fushë, sepse vetëm në momentin e fundit e mora në dorë, po nëse ka interesa unë mund të gjej shembuj të shteteve të tjera në lidhje me këtë.

Kjo ishte një panoramë e shkurtër e rekomandimeve që janë bërë në këtë fushë të caktuar të zgjedhjeve. Jam në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar më shumë informacione ose të diskutojmë pikëpamjet për çështje të ndryshme, gjithashtu të flasim për hollësira teknike për t'ju ndihmuar mbase edhe me rekomandime konkrete që doni t'i shikoni të zbatuara në legjislacionin e ri apo në zgjedhjet e ardhshme.

Ju falënderoj shumë dhe mezi po pres të dëgjoj diskutimet!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit Nicola për prezantimin e të gjithë problematikës që ka dalë në këto zgjedhje. Ju e filluat që nga 2011 sepse ka të tilla që fillojnë nga ajo periudhë!

Këtu u prekën një seri temash, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me fushatën apo në mënyrë të tërthortë, por që janë pjesë e saj.

Për shembull, në momentin kur flasim për hartimin e fletës së votimit, në dukje nuk është çështje e fushatës, por është një nga temat që formalizon mënyrën se si e bën fushatën.

Unë besoj se ne jemi në traditën e plotë të mbledhjeve të komisionit, ne jemi në planin tonë të punës dhe tani që po hymë te detajet nuk mund ta shmangim fokusin. Këtu doli çështja e regjistrimit të kandidatëve. Unë e kuptoj që shumica e subjekteve politike që janë në këtë tryezë nuk e kanë këtë problem. Në një mënyrë ose në një tjetër e zgjidhin, ose i kanë në parlament dhe kapërcejnë detyrimin e regjistrimit dhe paraqitjes së firmave, nuk kanë shqetësimin e verifikimit të firmave të tyre, por ky është problem real.

Ky është një komision që do të trajtojë problemet e procesit zgjedhor, jo vetëm problemet e partive politike që janë anëtare të këtij komisioni. Ne sot e dimë që kemi një zgjidhje, e cila është totalisht në përputhje me praktikat ndërkombëtare, por ende sot e kësaj dite qoftë ligji ka ndofta paqartësi, qoftë KQZ-ja duhet të marrë masa të tjera për të qenë më i qartë, më konsistent dhe më transparent, jo vetëm KQZ-ja por cilido organ tjetër që përfshihet në

mënyrën se si bëhet ky verifikim, në kohën kur bëhet dhe në bindjen që u krijon të gjithë subjekteve të tjera, që ndoshta s'janë në këtë tryezë, është detyrimi ynë që t'ua garantojmë, në mënyrë që ata të besojnë se verifikimi i firmave të tyre nuk është fals, i padrejtë apo që detyrimi është më i fortë se sa duhet, pra e përballojnë apo jo.

Këtu dolën probleme në regjistrimin e kandidatëve, që kanë të bëjnë me afatet dhe shpeshherë subjektet (ndoshta partitë e mëdha jo, por qoftë edhe parti të vogla që janë këtë komision) janë ndeshur me probleme në regjistrimin e kandidaturave dhe nëse ky nuk është problem sot në këtë diskutim të komisionit, kur vjen momenti i problemeve në KQZ apo në kolegji, kthehet në problem politik. Pra, nuk besoj se është i neglizhueshëm për tagrin që ka ky komision.

Çështja e grave në regjistrimin e kandidatëve u përmend në mënyrë edhe më të detajuar. Sot ne kemi avancuar në një nivel të caktuar të kuotave ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Mediu – Më falni, në cilën pikë të rendit të ditës jemi, se në bazë të ekspertëve duhej të bënim pyetje ne?

Në qoftë se bëjmë vlerësime mbi vlerësimet e ekspertëve, na thoni ta dimë edhe ne ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Oerd Bylykbashi – Kemi regjistrimin e kandidatëve si çështje që duhet diskutuar. Kemi çështjen e pjesëmarrjes së grave që del nga rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, është pjesë e fushatës. Kemi çështjen e pjesëmarrjes së minoriteteve, që doli nga prezantimi.

Kemi çështjen e fushatës, pra elemente që kanë të bëjnë me mënyrën se si organizuar fushata.

U ngrit çështja e ankimeve, që nuk ka një tryezë të veçantë, që të trajtohej këtu dhe unë ngrita më herët edhe çështjen e dekriminalizimit.

Me ligj i kemi hequr mundësinë personave me rekord kriminal që të jenë pjesë e të zgjedhurve dhe institucioneve.

Po ashtu e dimë dhe kjo del edhe nga raporti i OSBE/ODIHR-it që këta persona janë transferuar tashmë te strukturat drejtuese të partive politike që drejtojnë fushata, me impakt negativ të drejtpërdrejtë në mënyrën se si bëhet fushata dhe konkluzioni i saj, e për rrjedhojë edhe kjo është një çështje që unë gjykoj se duhet trajtuar.

Do të ftoja kolegët që të fillojnë t'i marrin e t'i trajtojnë këto çështje, kush ka vërejtje, kontribute në lidhje me tematikat specifike apo tematika të tjera që mendojnë se janë të papërfshira. Kjo është e hapur.

Kush e do fjalën?

Zoti Rama.

Luan Rama - Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Më jeni fillimisht të shpreh një konsideratë për gjithë çështjet që parashtroi zonja Schmidt, që realisht është një përmbledhje apo një rikapitulim i një morie problemesh, që ne i kemi hasur në proces, pothuajse gjatë të gjitha zgjedhjeve që janë zhvilluar në Shqipëri.

Ajo që dua të them është më shumë e karakterit procedural. Nëse kemi një bllok problemesh, që kemi evidentuar, do të duhej që për secilin prej tyre ekspertët të sjellin draftin apo propozimin konkret, në mënyrë që ne të gjykojmë mbi bazën e asaj që na ofrohet për të rregulluar problemin, se kështu mund të hymë në një diskutim prapë në parim, do të fillojmë prapë nga e para, secili ka konsideratat e veta dhe përfundimisht nuk do të shkojmë asgjëkund.

Pra, drafti me shqetësimet dhe problemet u jepet ekspertëve dhe ekspertët vijnë dhe thonë këtu duhet të rritet transparenca për shembull nëpërmjet botimit të vendimeve. Në qoftë se ky është problem, si zgjidhet.

Të qartësohet kuadri ligjor për ankimet. Ju thatë, problemi i grave. Po si zgjidhet? Të na vijë drafti nga ekspertët dhe ne kemi të drejtën pastaj të gjykojmë mbi bazën e draftit dhe të vendosim për draftin. Kjo do ta bënte më efektive dhe më produkteve punën praktikisht.

Faleminderit!

Bledar Çuçi– Faleminderit, zoti Rama!

Pa diskutim që do të vijmë te faza që ekspertët do të na japin variantet e tyre, por ne gjykuam dhe prandaj e bëmë platformën që përpara se ata të shkruajnë, që t'i orientojmë disi. Domethënë, fjala bie te pjesëmarrja e grave, ne si politikanë, pra si pjesë e komisionit, do të jemi me qëndrimin që do të vazhdojmë me penalitete, me gjoba për ata që nuk plotësojnë kriterin sipas ligjit, apo do të shkojmë në variantin ekstrem, që s' do ta pranojmë listën që në fillim.

Pra, ky është një qëndrim politik dhe eksperti i OSBE-së na jep disa shembuj nga vendet e tjera, na jep standardin sipas dokumenteve ndërkombëtarë, ku edhe ne jemi pjesë dhe ne këtu, prandaj është takimi sot, të shprehim nga një opinion politik në këtë rast, në mënyrë që të

furnizojmë pastaj ekspertët (ekspertët kanë ekspertizën, kanë qëndrimin tonë politik) vijnë me variante.

Në qoftë se ne qysh në fillim, me qëndrimin politik biem dakord, ekspertët e kanë shumë të thjeshtë. Të gjithë ekspertët sjellin një variant. Në qoftë se ne kemi disa mendime për një çështje të caktuar, eksperti mund të vijë me dy apo tre variante. Kështu që, ky është momenti që ne të shprehemi politikisht për disa qëndrime.

Ekspertja solli si shembuj disa raste si bëhen listat në vendet e tjera, për shembull, në Gjermani që mund të jetë një diskutim relevant. Gjermania u imponon partive politike një proces zgjedhor të brendshëm, pra që lista e kandidatëve të dalë nga një proces zgjedhor brenda partisë dhe këtë e imponon ditën kur çon listën në KQZ për t'u regjistruar dhe i thotë do më sjellësh gjithë dokumentacionin që ti ke për procesin që ke bërë brenda partisë.

Pra, këto janë disa qëndrime politike që ne duhet t'i diskutojmë, t'i rrahim paraprakisht dhe ekspertët të na vijnë pastaj me variante dhe ne prapë kemi mundësinë të diskutojmë edhe mbi variantet, përveçse diskutojmë nëse mënyra se si e kanë shkruar ekspertët e kënaq zgjidhjen tonë politike apo jo, diskutojmë prapë edhe nëse kemi qëndrime të ndryshme në lidhje me këtë.

Prandaj unë i ftoj të gjithë kolegët që për çështjen që kemi sot të japin konsideratat e para politike në lidhje me këtë çështje. Unë e kuptoj që pjesa e fushatës ndoshta mund të mos jetë shumë intriguese sa çështjet e tjera që do të diskutojmë, por gjithsesi sot jemi për këtë gjë, prandaj ta ezaurojmë sot meqë e kemi pjesë të fushatës.

Kështu që besoj se kjo është mënyra më e mirë për të pasur produktin më të qëndrueshëm konsensual.

Faleminderit!

Luan Rama – Nuk jam kundër, jam dakord, por ka një gjë. Për shembull, çështja e qëndrimit ndaj pjesëmarrjes së grave në listë. Ne, secila forcë politike e pranishme në komision, ka një qëndrim të vetin të artikuluar edhe më parë në komisione, e kemi edhe të shkruar si draft, se i kemi paraqitur draftet, sepse ky komision nuk mblidhet sot për herë të parë dhe ne mund t'ua sjellim draftin konkretisht, mund të themi, fjala vjen, për këtë çështje jemi që të penalizohet, të mos i pranohet lista atij subjekti politik që nuk plotëson kriterin e barazisë gjinore. Ne e kemi draftin gati për këtë gjë. Pse lind nevoja që ta themi edhe një herë këtë gjë që e kemi thënë, kur mund ta sjellim draftin gati?

Ne nuk kemi ndryshuar qëndrim për sa i përket transparencës së procesit, nuk kemi ndryshuar qëndrim për sa i përket çështjes së penalteteve që lidhen me dekriminalizimin, me shanset e barabarta, me praninë e grave në listë, me listat e hapura apo me votimin selektiv përmes një procesi zgjedhor brenda partisë. Ne i kemi të draftuara, e kemi projektin gati, ua vëmë në dispozicion projektin dhe hajde të diskutojmë. Ne kemi punuar, se specialistët që kemi ne kanë 15 vjet që e bëjnë këtë punë.

Domethënë, gjendemi përballë faktit, që ne jemi gati ta ofrojmë, të bëjmë ofertën tonë konkrete, me draftin konkret. për ta përshpejtuar procesin, them unë e për ta bërë më efektiv.

Oerd Bylykbashi – Unë jam dakord që ne të marrim e të diskutojmë draftet, por besoj se, nëse secila palë do të vijë me draftin e vet, duke thënë se ne e kemi draftin, nuk do të mund të arrijmë dot. Le t'i marrim çështjet njëërën pas tjetrës. Ka çështje që kanë karakter teknik, shumë teknik. Ka gjëra që i rregullon KQZ-ja, pa pasur nevojën tonë. Gjithashtu, në këtë sesion, unë do të doja të dëgjoja nga KQZ-ja, për të mësuar se çfarë qëndrimesh kanë në lidhje me problemet që kanë parë, dhe çfarë nevojë kanë nga ne. Për shembull...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luan Rama – Ne e kemi diskutuar në proces shumë më herët. Tani, KQZ-ja vërtetë është trupë kushtetuese, por prapë do të bëjë çfarë do t'i thonë partitë, sepse partitë e kanë zgjedhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Trupë administrative. Problemi shtrohet këtu, dhe kjo është themelore: do të ecim me sistemin e komisioneve partiake apo me komisione jopartiake? Nëse nuk zgjidhim këtë, çfarë do të bëjë komisioni pastaj? Ne nuk kemi zgjidhur problemin e sistemit. Problemi i sistemit imponon të gjithë teknologjinë e zgjedhjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, parimisht. E kam të qartë, e di. Po abstragoj: në qoftë se ne, si komision, do të vendosim të moderojmë sistemin zgjedhor pa e prekur Kushtetutën, kjo imponon teknologjinë e zgjedhjeve. Në qoftë se do të vendosim teknologjinë elektronike të votimit, ajo është e ndërvarur nga sistemi zgjedhor. Jemi një vit para zgjedhjeve lokale. A do ta bëjmë projektin pilot, siç është thënë? A do të futet teknologjia? Sepse, nëse nuk mbaron deri në fund të majit, nuk e bëjmë dot.

Ne nuk bëjmë dot votim as në test, as në projekt pilot, siç quhet, në asnjë njësi, në asnjë bashki, në asnjë qark, nëse nuk e vendosim këtë të paktën një vit para zgjedhjeve.

Diskutojmë sa të doni për këto, nuk e kam problem. Problemi që shtrohet është: që ne nuk do të mbërrim dot te standardi që kemi vendosur.

Oerd Bylykbashi – Unë jam dakord. le ta mbajmë të fokusuar. Kjo që thatë ju është shumë e drejtë. Mënyra se si ne do të zgjidhim çështje të caktuara, do të ndikojë në elementë të tjerë. Është parashikuar që administrata zgjedhore të jetë më vonë, ndër të tjera, edhe për arsyen se më përpara do të vendoset në lidhje me teknologjinë, e cila mund të na çojë në rimendim të të gjithë skemës administrative. Do të kemi mbledhje vetëm për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pavarësisht se çfarë do të zgjidhim në të ardhmen. kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të jetë një person, mund të jetë dhjetë persona, mund të jetë politik ose jopolitik, unë mendoj se kanë mbledhur një eksperiencë shumë të vyer për fushatën. Çështja që shtrohet këtu sot, le t'i marrim një për një, është: a kemi problem me afatet e regjistrimit të kandidatëve? Nëse kemi problem, a keni konstatuar ju, KQZ-ja apo kushdo tjetër... Pra, duhet t'i zgjasim. Duhet t'i bëjmë më të koordinuar, sepse i mbivendosen njëri-tjetrit, duke bërë që ankimi në gjykatë të jetë joefektiv, sepse ndërkohë ka filluar fushata. Ky është momenti për ta thënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është hapësira për komisionin, që, nëse s'ka, dëgjon KQZ-në.

Po, zoti Mediu.

Fatmir Mediu – A mund të bëjmë një gjë, e cila të jetë sa më racionale? Të ndajmë komisionin me ekspertët. Unë vlerësoj të gjithë prezantimin që bëri zonja Schmidt, me principet, parimet, referencat e me problemet që janë. Çështjet që u shtruan janë çështje që duhet të diskutohen në nivelin teknik, siç ka ndodhur edhe herë të tjera, për t'i prurë në vendimmarrje politike të komisionit. Në qoftë se ju na konsideroni ekspertë teknikë në këtë komision, mendoj se është gabim. Ne kemi përcaktuar një grup ekspertësh, të cilët të gjitha këto probleme, shorti gjatë zgjedhjeve e të tjera, identifikimet e problemeve, duhet t'i nxjerrim dhe të sjellim mendimet e palëve përkatëse, si vendimmarrje politike, në lidhje me atë që biem dakord dhe me atë që nuk biem dakord. Aty ku nuk biem dakord do të kërkojmë mbështetjen e OSBE/ODIHR-it apo të institucioneve të tjera, për praktikën më të mirë.

Unë po ju them: ky diskutim që bëjmë ne nuk do të na çojë asgjekund, në qoftë se nuk do të kemi produkt të trajtuar, bazuar mbi këto që u referuan nga grupi i ekspertëve. Çfarë po bëjmë ne? Ne, domethënë, unë Luani, ju, kemi marrë pozicionin e ekspertëve këtu. Ekspertët, që janë teknikë për këtë çështje, në bazë të identifikimit të problemeve, të japin përgjigje. Ajo për të cilën bien dakord është jeshile, ajo për të cilën bihet gjysmë dakord, është e verdhë, ajo për të cilën s'biem dakord është e kuqe. Me blu këta ndërkombëtarët, dhe nxjerrim se cila është zgjidhja.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Mediu!

Edhe një herë: ne nuk jemi në nivel teknik, zoti Mediu!

Meqë mora shembullin me pjesëmarrjen e grave, vendimmarrja nëse do të forcojmë apo jo komponentin e kuotës gratë, është vendimmarrje politike, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, më faj! Më fal ta mbaroj!

Fatmir Mediu – Si do t'i mësojmë romët për të votuar? Kjo është teknike apo politike?

Bledar Çuçi – Një minutë, pra, një minutë!

Pra, do të shkojmë me refuzim liste, apo do të forcojmë sanksionet? Kjo është vendimmarrje politike. Nuk është vendimmarrje teknike. Kjo është vendimmarrje politike. Ne marrim disa vendime, diskutojmë, të themi më mirë, në lidhje me disa vendime, opinione politike, në mënyrë që furnizojmë ekspertët dhe t'i qartësojmë, t'i vëmë në shina sa më të drejta. Pastaj, ata na sjellin draftin, e ne sigurisht që do të diskutojmë edhe një herë draftin, në mënyrë përfundimtare.

Prandaj po them: këtu ka disa gjëra, të cilat mund t'i diskutojmë politikisht.

Fatmir Mediu – Zoti Çuçi, më fal edhe një herë!

Që të jemi të qartë: në qoftë se ka çështje politike, të ndajmë çështjet politike që na takojnë ne për të diskutuar, nga çështjet teknike, të cilat u takojnë ekspertëve për t'i diskutuar. Kur biem dakord në çështjet politike, atëherë t'u themi ekspertëve: na i ktheni në një material teknik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bledar Çuçi – Ekzakt!

Fatmir Mediu – Bazuar mbi ato gjashtë pika që thatë ju. Por nuk po e bëjmë.

Bledar Çuçi – Faleminderit, që erdhe në këtë pikë. Je i pari i ftuar që të flasësh për çështje që ti sheh se janë politike këtu, dhe të japësh një opinion politik tëndin në lidhje me këtë çështje. Një qëndrim tëndin politik.

Fatmir Mediu – Po, po, e kam politik, po jua them edhe një herë. Doni ta filloni me radhë? Është aty ku e tha zoti Luan Rama. Asnjë gjë nuk mund të funksionojë, nëse nuk ka një koncept për sistemin zgjedhor. Më thoni si komision: cilit model duhet t'i referohemi për të garantuar një parlament me kompetencë të plotë kushtetuese të një republike parlamentare, ku deputetët janë të zgjedhur nga qytetarët? Elementi i dytë: garantimi i zgjedhjeve të lira e të ndershme, ku përfshihen të gjitha elementet e tjera që thoni ju. Në radhë të parë, çështja është: do të kemi apo s'do të kemi parlament? Do të kemi institucion të emëruar apo institucion të zgjedhur? Ky është problemi i parë që kemi sot në Shqipëri, ku nuk funksionon i gjithë sistemi ynë kushtetues. Sipas gjykimit tim. Pra, sistemi zgjedhor duhet diskutuar: është apo s'është funksional? Pastaj kalojmë te çështjet se si do të garantojmë zgjedhje të lira e të ndershme. në qoftë se ne themi se kemi një republikë kushtetuese parlamentare, parlamenti, si institucioni bazë, duhet të jetë i zgjedhur, përfaqësues i qytetarëve, jo vetëm thjesht përfaqësues i vullnetit të lidershipit politik.

Shkojmë më tej. Për të garantuar zgjedhje të lira e të ndershme është çështja e votimit dhe e numërimit elektronik apo identifikimi elektronik. Si do të ecim me këtë proces? Cilët janë shembujt? Si do t'u referohemi këtyre shembujve? Për të kaluar pastaj te elementët që janë politike e teknike, të një vullneti politik, si blerja e votës e kështu me radhë.

Ka çështje teknike, të cilat kanë dalë, që raporti i OSBE/ODIHR-it ka nxjerrë dhe që kemi identifikuar çështjet teknike. Mbi këto çështje teknike, do të ishte mirë që sot të kishim një produkt të grupit të ekspertëve.

Po ju kujtoj se zoti Bylykbashi ka punuar te OSBE/ODIHR-i, sepse nuk është hera e parë që bëhet reforma zgjedhore. Në atë kohë, drejtuesit e OSBE thërrisnin grupin e ekspertëve, dhe i thoshin: çfarë problemesh kemi identifikuar sot? Vërehej sa binin dakord, mbahej shënim, vazhdohej me mosdakordësinë. Pastaj, materialin e dakordësuar në konceptin teknik, grupi i ekspertëve e sillte për vendimmarrje. pastaj procedohej me problemin tjetër.

Kjo ka qenë praktika. Unë nuk mendoj se duhet të shpikim ndonjë gjë. Por, po ju them se kërkesa ime është: ejani të shikojmë se cilat janë modelet, të cilave duhet t'u referohemi!

E thashë qëparë: “Berberi i ri e mëson dorën mbi kokën e fukarait”. Nuk ka nevojë për ndonjë shpikje nga ana jonë. Sepse vetëm shpikje kemi bërë, prandaj dhe jemi në këtë situatë ku jemi.

Oerd Bylykbashi – Zoti Mediu, meqë ju iu referuat një eksperience në të shkuarën, më herët kishim këtu edhe një nga bashkëkryetarët e asaj kohe. Meqenëse në atë kohë unë kam qenë bashkëkryetar i grupit të ekspertëve, të gjithë pjesëmarrësve u kujtoj vetëm një gjë. Do të doja të lëviznim nga ky diskutimi në parim i procedurës, por gjithsesi, le ta trajtojmë. Grupi i ekspertëve të OSBE-së, qoftë dhe ai të cilit juve iu referuat në kohë, ai i vitit 2004, ku merrnin pjesë edhe anëtarë të partive politike, e merrte detyrën nga komisioni. Caktoheshin çështjet politike, më pas shtonte të gjitha elementet teknike që dilnin nga rekomandimet. Por merrte detyrën, merrte autorizimin për ta trajtuar një çështje të caktuar. Për shembull, rasti i votimit dhe i një numërimi të përqendruar. Ishte vendimmarrja e komisionit. Grupi i ekspertëve e shkroi dhe e prezantoi në komision. Mori dakordësinë në lidhje me ndryshimet përkatëse. Këtë jemi duke bërë. Sot ne po ngremë çështjet, të cilat do të jenë të tjera nga ato që kemi parashikuar në planin e punës. Pra, fushata dhe çështje të tjera.

Tani le të kthehemi pak te çështja e sistemit.

Në zgjedhjet e ardhshme vendore, të jemi të qartë, kemi zgjedhje vendore, do të mbetet sistemi mazhoritar në zgjedhjen e kryetarëve të bashkive. Nuk kemi për të ndryshuar ndonjë gjë. Në këshilla do të kemi sistemin proporcional, këtë që kemi sot, dhe nuk besoj se kemi për të ndryshuar ndonjë gjë. Diskutimi juaj është për sistemin zgjedhor në lidhje me parlamentin, i cili nuk është i mbyllur në këtë komision. Por, nëse ne e diskutojmë atë sot, kemi zgjidhje apo jo, problemi i regjistrimit të kandidatëve është i paprekur, nuk preket dot nga sistemi. Kandidatët do të regjistrohen gjithmonë njësoj. Nëse do të renditen gratë një në tri të parat, një në çdo dy apo një në çdo tri, ky mbetet përsëri i paprekur, për sa kohë që nuk shkojmë në një sistem mazhoritar.

Pra, këtyre t’u japim zgjidhje. Nuk është lloji i problemit që, po ta kapësh nga brirët e sistemit zgjedhor, zgjidh të gjitha problemet e tjera. Administrata zgjedhore do të funksionojë pavarësisht llojit të sistemit.

Fatmir Mediu – A t’ju bëj një pyetje, zoti Bylykbashi? A kemi rënë dakord, që do të implementojmë 100% rekomandimet e OSBE/ODIHR-it?

Oerd Bylykbashi – Po, ky është detyrim.

Fatmir Mediu – Po pra! këtë detyrim, a duhet ta kthejmë në një vlerë vendimmarrjeje, nga teknik në politik?

Oerd Bylykbashi – Do të marrim njëherë vendimet politike që duam ne. Tani, ne nuk do të marrim vendim politik për çdo lloj detaji edhe nga ato që u prezantuan sot. Pyetja që shtrohet këtu: do të vendoset kuotë më e fortë apo do të forcojmë sanksionin për kuotën ekzistuese? Ky është vendim politik.

Fatmir Mediu - Të mos bëjmë *hand picked* të një problemi apo të një tjetri. Ajo që po them unë është: kemi rënë dakord se do të zbatojmë rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Dakord? Pjesa më e madhe e tyre, në 70% janë çështje teknike. Kemi ngritur një grup ekspertësh këtu dhe kaloi gati 4-5 muaj. Mbaruam mandatin. Ky grup ekspertësh bazuar mbi këtë dakordësi politike tonën nuk ka sot një produkt. Grupi i ekspertëve që kemi zgjedhur ne, nuk ka një produkt. Nuk i mbledh njeri ekspertët. Të ulen të gjithë ekspertët e palëve dhe të diskutojnë për çështje të cilat kemi rënë dakord politikisht për t'i trajtuar, flas në nivel teknik. Ata ekspertë nuk janë pa përvojë, e dinë se cilat janë çështjet teknike. Pastaj të thonë, sipas rëndësisë që nuk e përcaktojmë vetëm ne, por rëndësisë që vjen nga gjykimi i ekspertëve se cili është rendi i gjërave që duhet të trajtojmë ne në vendimmarrjen tonë politike që ka të bëjë me zgjedhjet lokale që janë afër dhe me zgjedhjet parlamentare. Po të fillojmë të kalojmë nga gratë, te romët, te çështjet e tjera, mendoj se vetëm krijojmë konfuzion. Ka disa gjëra të cilat kanë prioritet. E tha edhe zoti Rama, nëse ne nuk marrim vendim në një kohë të caktuar është e pamundur edhe po të themi ne do të bëhet votimi elektronik, nëse kalohen disa afate, po ju them se do të vijmë te koha që nuk e implementojmë dot dhe e gjithë puna do të na shkojë dëm. E kemi provuar që na ka shkuar dëm edhe më parë. Ajo që unë kërkoj është të bëhemi racionalë në një gjë: ne t'u themi teknikëve që kemi vënë, se cilat janë ato çështje të OSBE/ODIHR-it që të gjithë jemi dakord se duhet t'i implementojmë, se duhet t'i sjellin në një material, pra të gjitha shqetësimet e ngritura në një produkt të miratuar nga ky komision. Të fillojmë të miratojmë diçka. Pastaj të na shtrojnë edhe çështjet sipas prioriteteve që kanë të bëjnë me zgjedhjet lokale dhe me zgjedhjet e përgjithshme për të trajtuar të gjithë problematikën që shtrohet.

Oerd Bylykbashi - Zoti Mediu, më fal, kam vetëm diçka të shkurtër.

Zoti Fino, për procedurë.

Bashkim Fino- Më vjen keq, prandaj e mora fjalën për procedurë. Ky nuk është një debat i Fatmir Mediut dhe Luan Ramës dhe dy bashkëkryetarët, se ndihemi edhe ne si jashtë loje në sensin e respektimit. Nuk kam asnjë vërejtje për problemet që ngrenë dy kolegët e mi, shumë mirë që i ngrenë! Ne kemi një rend dite, kemi një seminar që po bëjmë, unë kam propozimin normal: ju bashkëkryetarët, se ju e organizoni mbledhjen, të vini të organizuar me dy grupe, në kuptimin e mbledhjes që bëjmë, të lihen disa detyra konkrete sot për grupin e ekspertëve, të cilët të na sjellin në mbledhjen tjetër një draft, një material mbi të cilin të fillojmë dhe të flasim edhe ne politikisht, sepse më duket se po bëhet ping-pong, flet Fatmiri 10 herë, i kthen përgjigje ti, i kthen përgjigje Çuçi, nuk e kuptoj. Do të kemi një rezultat të mbledhjes së sotme apo jo? A e dëgjuam ekspertin? Po! T'i marrim këto, të lihen disa detyra, i votojmë po të doni edhe ne me grupin e ekspertëve dhe javën tjetër të na sjellin një material, për 5-6 ditë, një javë apo për 10 ditë të diskutojmë atë material, se kështu duket sikur po bëjmë debat midis dy vetave.

Më falni, që ndërhyra, por nuk e kemi kohën e tepër! Nëse ju doni të bëni një debat si bashkëkryetarë me zotin Rama, me zotin Mediu, mund ta bëni, por pa praninë tonë, mua personalisht nuk më intereson. Sinqerisht e quaj kohë të humbur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Debat për këtë rendin e ditës që kemi ardhur këtu, jo për...

Për të drejtat tuaja, unë sapo ju thashë se keni të drejtat tuaja, por Fatmir mua nuk më intereson. Edhe unë kam të drejtën time apo jo? Nuk mund të qëndroj këtu dy orë e ca dhe të dëgjoj replikën dhe ping-pongun tënd. Mua më intereson gjë tjetër: a mund të lini disa detyra për grupin e ekspertëve? Të na paraqesin një material javën tjetër, ta diskutojmë, kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kam gjë personale me ju. Ju keni të drejtën e Zotit, por edhe unë kam të drejtën time. Sinqerisht e quaj kohë të humbur të dëgjoj replikën tënde sidomos kur flet Çuçi, nuk ka pse flet fare, le të flasë Bylykbashi me ty.

Bledar Çuçi - Faleminderit zoti Fino!

Edhe një herë, sot ashtu siç e vuri në dukje zoti Fino kemi një rend dite dhe po diskutojmë mbi një rend dite, nuk mund të flasim për çdo gjë që ka të bëjë me zgjedhjet. E fillova mbledhjen duke ju rikujtuar se kemi miratuar një platformë dhe një kalendar se si do të ecim me punën e komisionit. Sot po trajtojmë pikën 4/1 të platformës që ne kemi miratuar. Të

gjitha çështjet që tha zoti Mediu, sigurisht që do të trajtohen sipas kësaj platforme që ne kemi miratuar. Pra, ju ftoj të fokusohemi te kjo platformë, te kjo pikë që kemi në axhendën e ditës së sotme! Të mos hapemi si vaji në lakra, sepse nuk do të arrijmë dot në përfundim. Pikërisht kështu do ta përfundonim mbledhjen e sotme, për pikën 4/1 të platformës pasi të diskutonim, ekspertët të merrnin detyrën për të na sjellë ne rekomandime, amendime, çfarë mendojnë ata se duhet ndryshuar. Nga njëra anë më mirë që u bë ky diskutim, që të bëhemi të gjithë koshientë se kështu do të ecim për çdo pikë që kemi në platformë.

Të dëgjojmë edhe qëndrimin e KQZ-së në lidhje me këtë gjë, pra me çështje që i takojnë fushatës dhe rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it.

Bledar Skënderi - Së pari, dua të sqaroj se nuk është qëndrim zyrtar i KQZ-së, por është qëndrimi im personal si anëtar i KQZ-së. Meqenëse jemi te pjesa e regjistrimit të kandidatëve për mendimin tim, si anëtar i KQZ-së unë do të shprehja 2-3 qëndrime.

E para, duhet të saktësohet më mirë në Kodin Zgjedhor afati i regjistrimit të kandidatëve për zgjedhjet, sepse në këto zgjedhje ne patëm probleme me llogaritjen e aftit dhe u bë debat i madh politik për këtë pjesë. Bashkëkryetari ka qenë atje para KQZ-së, ka bërë edhe deklaratë publike thjesht për pjesën sesi u bë llogaritja e afateve.

E dyta, sanksionet financiare për respektimin e kuotës gjinore jo vetëm kanë dështuar, por në këto zgjedhje u kthyen në qesharake. Këtu tregohet se kjo gjë nuk funksionon fare. Ne arritëm të gjobisnim një parti politike, sepse diskriminoi seksin femër, në një qark kishte vënë tre të parët të gjithë meshkuj, kjo nuk funksionoi aq më tepër që një parti tjetër e madhe mori në 12 qarqe 12 gjoba, sepse në asnjë qark nuk respektoi kuotën gjinore. Si zgjidhet kjo? Është shumë thjeshtë. Për zgjedhjet e pushtetit lokal, lista e kandidatëve është vendosur një femër, një mashkull dhe Kodi ka sanksione, në momentin që ti nuk e respekton kuotën gjinore, kthehet lisat dhe ajo nuk miratohet. Nuk e dëmtojnë një parti 1 milion lek të rinj, për mosrespektimin e kuotës gjinore, por ti ia vendos sanksionin, nëse do vërtet që ta bësh, i thuhet të kthejë listën dhe ta sjellë të rregulluar. Në momentin që lista është e rregulluar, unë të regjistroj listën e kandidatëve. Pra, për zgjedhjet e pushtetit lokal është zgjidhur. Pjesa e 30%-shit, 50%-shit është një vendimmarrje politike. Ka edhe qëndrime të ndryshme që thonë: përveç kuotës mashkull, femër duan të fusin edhe disa kuota të tjera, por është një qëndrim politik, se çfarë kuotash duhet të futen. Për zgjedhjet lokale ka një veçori, unë do të them diçka për to: mund të vendoset një kuotë në tërësi

për kandidatët e kryetarëve të bashkisë, sepse për ta nuk ka kuotë gjinore fare. Një parti mund të sjellë në të gjithë Shqipërinë për të gjitha bashkitë kandidatë të të njëjtit seks, pa paragjykuar. Mendoj të futet një kuotë edhe për kandidatët në tërësi që të bëhet një listë totale, mund të ishte vendi për t'u diskutuar dhe vendi i një vendimmarrjeje politike.

Për regjistrimin e kandidatëve po them një gjë të fundit, nuk po e them si anëtar i KQZ-së, por si qytetar i këtij vendi, mua më pëlqen shumë përvoja gjermane, para se të bëhet lista e kandidatëve bëhet një përzgjedhje e tyre brenda partisë, me një sistem konkurrimi, një sistem zgjedhjesh brenda partisë. Kjo për mendimin tim personal do të rriste cilësinë e atyre që ulen në karriget e përfaqësuesve të popullit në Kuvend. Do të ishte një gjë shumë e mirë edhe për demokracinë, edhe për partitë politike, do të rriste edhe nivelin e demokracisë brenda partive politike. Nëse ka një gjë që vuan Shqipëria sot është se nuk ka demokraci brenda partive politike.

Bledar Çuçi - Faleminderit!

Kam një konsideratë për propozimin në lidhje me kuotat e kandidatëve për kryetar të bashkive, besoj se është pa vend, sepse nuk garanton asgjë. Ti mund të kandidosh, mund të caktosh një kuotë, por ndërkohë kandidati që është përballë ka vendosur një kuotë, por në vende krejt të tjera, pra përsëri ti mund të kesh përballje vetëm me gjini të njëjtë. Të ftoj t'i heqësh nga fjalori fjalët: seksi mashkull, seksi femër se je edhe përfaqësues i KQZ-së.

E dyta, asgjë nuk e garanton, sepse atë e zgjedh vota me sistem maxhoritar, pra përsëri ne nuk arrijmë dot asgjë edhe duke vënë kuota. Ne e kemi vënë në këshilla, mendoj se në këtë pikë jemi goxha të avancuar. E vetmja gjë që ne duhet politikisht të marrim një vendim është ajo që e thatë edhe ju, e kemi thënë po e themi të gjithë këtu, e tha edhe zoti Rama, që kemi gati një platformë të shkruar ne si parti politike, nëse do të duhet të shkojmë me refuzim liste apo të vazhdojmë me penalitete. Ky është për të qenë racional një vendim që ne duhet ta marrim këtu në finale, ndoshta do të marrim edhe një vendim tjetër politik më tej edhe në parlament.

Po, zoti Mediu.

Fatmir Mediu – Kam një pyetje për ekspertin, mund të bëjë edhe krahasimet, po flisnim për kuotat: në SHBA që nuk ka kuota, çfarë standardi demokratik shkelet? Pse nuk e kanë ata?

(Diskutim në anglisht)

Nicola Schmidt - As në senat nuk ka shumë gra në SHBA dhe nuk ka barazi në përfaqësim, ato po shkelin të drejtën e përfaqësimit të barabartë të burrave dhe të grave, por është sistemi i tyre, ky është sistemi juaj. Ju mund të vendosni se si doni ta bëni atë. Roli i ODIHR-it dhe vetë personalisht mendoj se duhet të ketë më shumë gra që përfaqësohen në parlament në Shqipëri, si edhe në vendin tim.

Ekziston Ministria e Brendshme ku të gjitha pozicionet kryesore janë të mbushura me burra në shtetin tim, unë nuk ndihem e përfaqësuar atje. Pra, është një problem jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha shtetet. Është diçka që ju do të vendosni nëse doni ta trajtoni apo jo, apo nëse jeni dakord me situatën siç është aktualisht. Rekomandimi i ODIHR-it kërkon më shumë përfaqësim të grave dhe më shumë pjesëmarrje, sepse ajo që ka vënë re ODIHR-i është se nuk ka të bëjë me rezultatin që ju keni në parlament. Pra, rezultati që ju keni në parlament nuk përfaqëson gratë. Nuk reflekton shoqërinë dhe përbërjen e shoqërisë. Ne kemi vënë re, gjithashtu, se përfaqësimi i grave është shumë i ulët në administrimin e zgjedhjeve po të shikojmë grupet e numërimit të niveleve më të larta të administratës zgjedhore, por vendimi është juaji. Ju e merrni vendimin se si doni ta trajtoni.

Jam e vetmja grua që ka folur deri tani në këtë tavolinë ose dy gra, nuk e di nëse foli një vajzë tjetër, por këtu po flasim kryesisht burrat. Mendoj se është diçka që duhet marrë parasysh nëse është diçka që doni ta ndërroni ose jo, por nuk ju detyrohet ta ndryshoni. Është rekomandim që bëhet. Mendoj se ka mënyra të thjeshta për ta zgjidhur, por është vendimi juaj nëse doni të forconi sanksionet, ose nëse doni t'i jepni një rol më të fortë KQZ-së, për shembull, për të çregjistruar listat apo për të refuzuar regjistrimin e listave që nuk i përmbushin kërkesat.

Gjithashtu, siç e tha edhe anëtari i KQZ-së, vitin e kaluar kishte një problem me zbatimin njësoj, konsistent të rregullave ekzistuese në lidhje me gjorbitjen e partive që kanë dorëzuar lista që nuk përputheshin me kërkesat gjinore.

Shqipëria nuk është vendi i vetëm ku ekziston një problem me kuotën ose me përfaqësimin gjinor, por vendet e tjera ndoshta do të shërbejnë si shembuj për Shqipërinë, por është diçka që mund të bëhet, sepse ju keni bërë hapa të mëdhenj përpara, po të shohim zgjedhjet vendore, lidhur me kërkesën për një në dy persona të jetë i gjinisë tjetër. Ky është një hap shumë i madh dhe është mjaft më përpara në krahasim me kuotat e përdorura nga shtetet e tjera.

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Fatmir Mediu – E falënderoj zonjën Schmidt për shpjegimin, por them që parlamenti është trupë e zgjedhur dhe duke qenë trupë e zgjedhur, të drejtën për të zgjedhur e kanë qytetarët, të cilët gjykojnë se kush do të jetë përfaqësuesi i tyre në atë trupë legislative!

Shqetësimi im është: në qoftë se sot po vini me një kuotë për çështjen e grave, që nga 30, ta çojmë 50, edhe 70, për shkak të vullnetit të mirë, por po flasim edhe për kuotat e minoriteteve, madje ndoshta edhe për kuotat e grupeve të tjera nesër, edhe kuota të tjera, do të kemi parlament të zgjedhur, apo do të kemi parlament të emëruar? Të ndajmë konceptin: parlamenti është trupë e zgjedhur përfaqësuese apo trupë e emëruar, për shkak të qëllimeve dhe kuotave të ndryshme? Ky është shqetësimi që kam unë.

Për më tepër, nuk besoj, me aq sa e njoh unë demokracinë amerikane, se atje nuk funksionon përfaqësimi, atje funksionon gara. Në konceptin e tyre duhet ndarë e drejta për detyrimet nga mundësia për të përfaqësuar dhe për t'u zgjedhur. Nuk besoj se është një shtet që i ka diskriminuar gratë, pasi mbi 15% të senatit janë gra sot. Ka një lëvizje jashtëzakonisht të madhe në këtë drejtim, edhe në Kongres ose në Dhomën e Përfaqësuesve, por kjo ka ardhur për shkak të kompeticionit, jo se partia i ka zgjedhur se duhet të jenë senatore.

Ka një ndryshim koncepti edhe në sistemin zgjedhor, domethënë ka të bëjë me demokracinë horizontale, me *primary election* e të tjerë, pra me një kompeticion shumë më genuin sesa ky që duam të bëjmë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj them që të ndajmë njëherë e përfundimisht në konceptin tonë, se po bëjmë reformë zgjedhore: do të kemi parlament të emëruar politikisht për shkak të preferencave të lidërshiptit politik, do të kemi parlamentar të emëruar për shkak të kuotave, apo do të kemi një parlament të zgjedhur nga votat e qytetarëve?

Mendoj se çdo vend e ka nivelin e demokracisë të bazuar paksa edhe mbi kulturën, ka të bëjë edhe me kuptimin e demokracisë. Në qoftë se do të përpiqemi të imponohemi, do të krijojmë vetëm struktura formale, jofunksionale, të cilat krijojnë dëme jo të vogla pastaj në funksionet që marrin, sidomos parlamenti në funksionet e tij kushtetuese, gjithnjë në gjykimin tim.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Mediu!

Fjalën e ka zonja Bushka dhe pastaj zonja Gjylameti.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Çuçi!

Në fakt, duke qenë se sot në këtë takim, sipas planit të punës, të miratuar së bashku në rend dite për diskutim, kemi vetëm ato çështje që u prezantuan nga ana e ekspertes, të cilën e falënderoj për prezantimin, unë do të doja të ndalesha në dy prej tyre: në çështjen e kuotës gjinore dhe tek të drejtat e minoriteteve në këto procese!

Për sa i takon kuotës gjinore, duke marrë në konsideratë tashmë përparimin e Shqipërisë në përfaqësimin e gruas në politikë, dhe marr këtu shkas nga rasti i ndryshimeve që kemi bërë në Kodin Zgjedhor për sa i takon përfaqësimit të barabartë të gruas, të paktën në lista zgjedhore për sa u takon këshillave bashkiakë, një situatë, në fakt, që jo vetëm është lavdëruar nga ndërkombëtarët, por ka sjellë rezultate pozitive edhe në punët konkrete të këshillave bashkiakë, në përbërje të të cilëve sot ka më shumë gra.

Po t'i shihni në të gjithë Shqipërinë, janë organizuar aleancat e grave këshilltare, me pjesëmarrje nga parti të ndryshme, pra jo vetëm nga njëra forcë politike, të cilat kanë marrë nisma të shtuara përtej vendimeve që merr këshilli bashkiak, duke i përkthyer më pas në nisma ligjore të vetë këshillave, që kanë sjellë përmirësime në situata të caktuara problematike për komunitetin. Kjo është pak me atë që do të duhet të bëjnë, por është një fillim i mirë për të treguar se kjo kuotë e rritur, e garantuar me ligj për pjesëmarrjen e grave në këshillat bashkiakë ka ndikuar në më shumë të mira për qytetarët.

Dua t'i rikthehem këtu edhe propozimit të bërë nga Forumi i Gruas Socialiste dhe nga deputetja Olta Xhaçka në mandatin e kaluar për sa i takon rritjes së përfaqësimit gjinor prej 50% të grave edhe në listat për zgjedhjet parlamentare. Mendoj se ky do të jetë përsëri qëndrimi politik i Partisë Socialiste. Mbaj mend në atë kohë se edhe Lëvizja Socialiste për Integrim ka qenë pro një nisme të tillë. Shpresoj të mos keni lëvizur nga ky qëndrim, dhe nuk e besoj këtë gjë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam edhe një sugjerim në lidhje me këtë çështje.

Në qoftë se do të gjendet modeli i përbërjes së listës, duke iu referuar kuotës 50%, do të duhet të shohim nëse do të jetë lista që do të garantojë pjesëmarrjen si kandidatë 50% apo ajo që del nga rezultati zgjedhor. Kjo ndoshta do të jetë në fokusin e punës së ekspertëve për të na paraqitur ne modelet, të cilat, pavarësisht se mund të garantojnë kandidimin e 50% të grave, në

bazë të listave të partive si kandidatë, në fund mund të ndodhë që jo 50% e tyre mund të jenë përfaqësuese direkte si deputete në Kuvend.

Ka modele të ndryshme, për të cilat unë nuk pretendoj se ne jemi ekspertë, asnjëri nga ne nuk mund të ketë monopolin e të gjitha aftësive, njohurive për këtë çështje, prandaj ndoshta ekspertët mund të na paraqesin disa modele, që ne të shohim kush na përshtatet më shumë. Cilido qoftë modeli, ajo që është e rëndësishme ka lidhje me zbatimin efektiv të asaj që do të garantojmë me ligj në rast se do të biem dakord.

Deri sot sanksionet që ka parashikuar Kodi Zgjedhor nuk kanë qenë efektive, sepse partitë nuk e kanë pasur problem, në qoftë se jam gabim le të më korrigjojnë përfaqësuesit e komisionit zgjedhor, paguajnë gjobën dhe, pavarësisht se e kanë paguar gjobën, nuk ka qenë ndonjë stres shumë i madh për partitë pse nuk kanë respektuar kuotat gjinore.

Propozimet më përpara kanë qenë drastike, sepse edhe nga ana e grave në politikë, edhe nga ana e shoqërisë civile ka qenë mospranimi i listës. Kjo është një çështje, ku të gjithëve do të na duhet të reflektojmë dhe ta mendojmë. Në qoftë se kemi vullnet real për ta rritur kuotën gjinore dhe për ta bërë efektive për të rritur përfaqësimin e barabartë të burrave dhe grave në parlament, ne duhet ta marrim seriozisht dhe të gjejmë një model që kur ta shkruajmë në letër, ta zbatojmë në praktikë. Ndërsa për sa u takon minoriteteve, ju vë në dukje se kemi miratuar tashmë ligjin “Për minoritetet”, kemi bërë edhe një diskutim në Komisionin e Ligjeve me zotën Bylykbashi.

Tashmë çështjet që u ngritën nga ekspertët kanë nevojë të konsiderohen nga ne për diskutim edhe politik, por duke pasur parasysh tashmë që kemi një vlerësim të minoriteteve në lokalitete të caktuara dhe jo në të gjithë Shqipërinë. Kjo është një çështje që, në gjykimin tim personal, mund të shihet në aspektin e zgjedhjeve lokale për sa u takon këshillave bashkiakë, por jo në ato të përgjithshme. Edhe për këtë do të na duhet të kemi modele nga vende të ndryshme.

Këto ishin sugjerimet që kisha për sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bledar Çuçi – Faleminderit, zonja Bushka!

Zonja Gjylameti, e donit fjalën?

Blerina Gjylameti – Po, faleminderit!

Një element që do të doja të theksoja është fakti se unë nuk mendoj kurrësi që kuota cenon funksionalitetin dhe aq më pak konkurrencën. Të themi që duke pasur një listë, e cila në fund do të duhet të ishte jo vetëm thjesht kandidat, por të dilte me një kuotë të barabartë, nuk mendoj se do të cenonte cilësinë apo funksionin e parlamentit shqiptar. Madje mendoj se në disa raste ka treguar se e ka përmirësuar, nuk e ka përkeqësuar.

Mendoj se pjesa tjetër e kolegëve të mi, që janë burra këtu, do të duhej që ta mbështesnin fuqimisht këtë gjë, sepse nuk mendoj se këtu jemi duke folur kush është maxhorancë dhe kush është minorancë, por po flasim për shanse të barabarta; po flasim për kuota të barabarta.

Unë nuk mendoj se një grua duhet të jetë parlamentare e përzgjedhur vetëm për faktin se është grua, por do të duhet të jetë për shkak të cilësive dhe asaj çfarë jep, çfarë do të prodhojë, çfarë do të përmirësojë dhe çfarë do të duhet të kontribuojë për të përmirësuar pjesën e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por meqenëse po thoni këtë gjë, nuk duhet t'i trembeni kuotës 50%, sepse çdokush nga ju që është i aftë do të jetë tek ajo 50%-shja që ngelet. Kjo do të thotë që nuk cenohet absolutisht nëpërmjet kuotës as cilësia, aq më pak konkurrenca e parlamentit të ri të zgjedhur nëse ne do të vendosim së bashku që kuota të pranohet.

Mendoj se kuota është një mekanizëm shumë i mirë për të dhënë shanse të barabarta, madje mendoj se së bashku do të duhet të gjejmë edhe nëpërmjet kontributit të ekspertëve, pikërisht atë formulë që e bën kuotën efektive, pra jo vetëm thjesht sikundër meqenëse këtu drejtohem të gjitha partitë, përveç një partie që ka ndryshimin e parë, nga burra, të presim që çfarë vullneti do të kenë, dhe kryesisht shumë pak e kanë treguar se kanë vullnet. Por do të duhet ne, së pari, që jemi kolegë të kuptojmë nëse kjo listë mund ta përfaqësojë më mirë popullin shqiptar dhe në parlament të përmirësojë ose jo punën që kryhet ditë pas dite.

Gjëja tjetër që unë mendoj se do të duhet ta shikojmë ishte një nga rekomandimet nga ekspertja, në mos gaboj, te pjesa e Gjermanisë, ku fliste për të gjithë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve dhe listës, dhe kjo që dorëzohej në komisionin zgjedhor...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...si një dokument së bashku me të gjitha dokumentet e tjera.

Mendoj se ky mund të jetë një hap shumë i mirë dhe do të duhet që ta diskutojmë të gjithë, pasi rrit demokracinë e brendshme në çdo parti dhe më pas kjo të shërbejë edhe në funksion të listës përfundimtare, ku përzgjidhen edhe më të mirët.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Po, zoti Rama.

Luan Rama – Duke marrë shkas nga diskutimi që u bë dhe çështjet që u fokusuan, dua të theksoj edhe një herë se ne kemi qenë dhe mbetemi partizanë të kuotave të barabarta. E kemi mbajtur atë qëndrim dhe jemi pro atij qëndrimi, duke specifikuar kriteret që gratë të mos vihen në lista, vetëm pse janë gra, por ato duhet të përfaqësojnë kualitete dhe të jenë kontribute reale brenda parlamentit, sepse për fat të keq, ka ndodhur që ne i respektojmë kuotat në kandidim, por më pas bëjmë spostime listash, gjejmë truke dhe modalitete për t'i zëvendësuar përsëri me burra në parlament.

Natyrisht, çështja e penaliteteve ka një karakter formal, e cila nuk e ka konsoliduar modelin që ne kemi ofruar. Këtu nuk bëhet fjalë për të ikur, sepse ne kemi tashmë një model, me ato mundësi që janë realizuar të përfaqësimit të grave në parlament nga i cili s'mund të ikim, por duhet ta forcojmë më shumë këtë përvojë të mirë, duke shkuar te raporti 50 me 50.

Për sa i përket çështjes së kandidimit apo përzgjedhjes së listës, sipas modelit gjerman përmes një procesi zgjedhor brenda strukturave të partisë, ne kemi pasur dhe e kemi të pandryshuar një propozim tonin dhe unë e hedh edhe sot për diskutim: propozimin e listave të hapura, që e kapërcen konceptin e garës brenda partisë. Lista e hapur u jepet qytetarëve që ta zgjedhin ata renditjen në listë dhe jo kryetari i partisë. Edhe në vendet rrotull nesh ka modele, që edhe me sistemin aktual që kemi (kjo nuk e cenon sistemin), t'u shkojmë qytetarëve me një listë të hapur dhe le ta zgjedhë qytetari në të gjithë Shqipërinë se kë do ai të jetë deputet nga secila prej partive tona. Kjo është demokracia funksionale, ky është pushteti i votës që i jepet qytetarit.

Kur ti, si kryetar partie, i vë Luanin të parin në listë, sado të përpiqet ai, nuk ka çfarë të bëjë se do të jetë i detyruar ta zgjedhë ose jo, edhe kur nuk e do.

Kur ti ia jep qytetarit listën nga A-ja te Zh-ja, je i 30-ti në listë, por merr vota më shumë se të gjithë të tjerët në të gjithë Shqipërinë, shko dhe përfaqësoje vullnetin e qytetarëve. Ky është një model, që unë mendoj se duhet ta marrim në konsideratë.

Çështja e dekriminalizimit është një çështje tjetër. Ne kemi marrë dhe e kemi trajtuar si një arritje të madhe të politikës këtë çështje, por në fakt kjo çështje është një turp i madh i politikës që trupa e zgjedhur dekriminalizon vetveten. Nuk mund të ketë paradoks më të madh. Këtë model nuk e ka asnjë vend, që një trupë e zgjedhur, forumi më i lartë i vendimmarrjes në një shtet, në një republikë parlamentare, miraton një ligj për të dekriminalizuar vetveten. Procesi nuk ka mbërritur në standardet dhe në pritshmëritë e ligjit, sepse çfarë ndodh? Ti e heq nga deputet, por e bën kryetar bashkie. Ti e heq nga deputet, sepse është person me rekorde kriminale dhe e çon kryetar partie, e bën shef të shtabit elektorale në zonën ku Luani kandidon për deputet dhe i vë Luanit suport nga pas këtë kriminel, që e heq nga deputet, që ai kriminel (po e vulgarizoj debatin) të sjellë Luanin në parlament, që Luani pastaj t'ia dijë për nder atij kriminelit më pas dhe kështu, të krijohet një raport i ndërvarur.

Sanksioni duhet të jetë i prerë. Një njeri që nuk meriton të jetë në bazë të ligjit me mandat përfaqësimi politik dhe publik në Kuvend, nuk mund të ketë asnjë të tagër përfaqësimi atje, ku ka impakt me qytetarin dhe me zbatimin e ligjit. Në të kundërt, procesi do të kthehet edhe në këtë rast një proces formal.

Këto janë 3 çështje që unë mendoj t'u jepen ekspertëve për të ardhur me një draft konkret qëndrimesh për të shtyrë më tej vendimmarrjen.

Faleminderit!

Bledar Çuci – Faleminderit, zoti Rama!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Unë mora shkas nga diskutimi i parafundit dhe kam një pyetje shumë interesante, e cila do t'i pëlqejë Fatmirit. Nëse ne do të mundohemi të fusim (se diskutim po bëjmë), modelin gjerman të konkurrimit brenda partisë për të cilin unë nuk kam asnjë vërejtje, a do t'i respektojmë kuotat? Në një konkurrim brenda partisë mund të fitojnë shumë femra, por mund të fitojnë edhe shumë meshkuj, gjë që do të thotë që ata do të shkojnë të konkurrojnë për parlamentin shqiptar. Kjo do të thotë që kuota nuk do të respektohet. Me këtë dua të them, zoti bashkëkryetar, që ne kemi bërë një punë të jashtëzakonshme në kodin aktual dhe gratë në Shqipëri duhet të ndihen krenare për atë punë që është bërë, sidomos nga partia që unë përfaqësoj, sepse sot kemi këshilla bashkiakë që e kanë barazinë gjinore 50% gra dhe 50% burra dhe kjo është një gjë shumë e mirë, që nuk e kishim më parë.

Sot të paktën në çdo 3 kandidatë njëra është femër. Për mua nuk fillon dhe nuk mbaron me diktatin që mund të bëjmë ne në Kodin Zgjedhor, duke vënë një kuotë të caktuar. Jo, për mua është demokratizimi i brendshëm i çdo partie politike. Po ju pyes, meqë kam pasur fatin të jem drejtues organizativ i PS-së për shumë kohë: Sa është sot kuota e grave tona në tërësi në strukturat e të gjitha partive politike? Zero, ose 10-15%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prit një sekondë, sa ta mbaroj!

Mos u mërzit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk të pyeta ty unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lër, se unë ju dëgjova me kënaqësi!

Çfarë dua të them me këtë? Dua të them, se ne si parti politike e kemi vendosur në statutin tonë, e kemi sanksionuar 40% në qytet dhe 30% në zonat rurale. Mendoj se kemi bërë diçka të mirë, por jo të arritshme kudo dhe jo të shkëlqyer. Duhet të luftojmë akoma më shumë për ta arritur këtë lloj kuote.

Po partitë politike, që nuk e kanë bërë një gjë të tillë?

Demokratizimi fillon nga partitë në radhë të parë dhe nuk fillon dhe nuk mbaron me kuotat përkatëse. Ti mund të vësh kuota dhe do të detyrohesh pastaj të marrësh elementë, individë, të cilët mund të mos jenë as të partisë tënde, por thjesht për shkak të kuotave, je i detyruar t'i vësh te ato lista, ndërkohë që trupa është një trupë që do të zgjidhet (siç tha edhe Fatmiri këtu), është demokratike që do të zgjidhet për parlamentin apo do të emërohet.

Pra, unë mendoj se kjo që kemi bërë deri tani, është e shkëlqyer. Duhet ta mbajmë fort dhe hajde ta përmirësojmë më tej për të rritur ndonjë përqindje më shumë. Absolutisht, por kjo duhet të kuptohet në radhë të parët te forcat tona politike, ku militojmë ne dhe duhet vërtet ta demokratizojmë më tej, sepse me modelin gjerman nëse e miratojmë nesër në Kodin Zgjedhor më rezulton që nuk do të ketë kuota. Ky model më rezulton se do të ketë demokraci brenda partisë, se kush do të dalë fitues, ai do të jetë në parlamentin shqiptar. Mund të jetë të gjitha femra apo të gjithë meshkuj. Atë nuk e di unë, por atë e di partia, kur është bërë debati dhe votimi brenda saj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse unë jam në një zonë me zonjën Gjylameti dhe luftojmë brenda partisë politike se kush do të jetë, dhe e fiton njëri nga ne, atëherë humbi kuota. Nëse fitoi ajo apo unë, fitohet kuota, por përsëri nuk e dimë se si fitohet kuota në vendet e tjera, por po flasim për modelin gjerman për konkurrimin brenda partisë.

Më falni!

Sa herë që unë flas, ti gjithmonë ndërbyn, Luan. Mirë e bën!

Faleminderit!

Bledar Çuci – Faleminderit!

Fatmir Mediu – Kisha një sugjerim për ekspertët.

Bledar Çuci – Një minutë! Me radhë!

Fatmir Mediu – A mundem?

Bledar Çuci – Pse po e bën zhurmuesin sot, se ti nuk e ke pasur asnjëherë zakon? Më falni, se e ka kërkuar fjalën zonja Felaj, më pas zoti Ndoka!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Unë do të pretendoja të ishim më sistematikë në diskutimet tona dhe t'u përmbaheshim çështjeve që listuam. Nuk e vë në dyshim sistemin, që do të zgjedhim nëse do të kemi këtë sistem aktual për zgjedhjet apo do të kemi një sistem tjetër.

Plani i punës e paraqet qartë çështjen për të cilën na duhet të diskutojmë, kështu që do të doja (merreni edhe si propozim këtë), meqë të gjithë e kemi një Kod Zgjedhor përpara dhe meqë po e fillojmë diskutimin tonë nga regjistrimi i subjekteve zgjedhore, të mund të shikonim çdo nen që lidhet me këtë pjesë apo me këtë seksion të Kodit Zgjedhor dhe të kujtonim se cilat kanë qenë problemet që na kanë dalë në zgjedhje. Për këtë mund të na ndihmojë edhe KQZ-ja (në rast se ne nuk na kujtohet diçka) dhe aty të fokusoheshim në diskutimet tona. Unë besoj se kështu do të ishte më logjik debati, se po të jemi të shpërndarë, nëse njëri diskuton për kuotën e gruas, tjetri diskuton për minoritetet, besoj se kjo nuk na jep mundësi që në fund të ditës të kuptojmë se në çfarë konkluzioni mbërritëm.

Le të ecim sipas një radhe diskutimesh. Nëse nuk ka gjë për regjistrimin, megjithëse unë besoj se ka. Po marr si shembull fjala vjen, që disa subjekte zgjedhore nuk mund të kandidojnë pa hequr dorë nga detyra, siç thotë neni 63 i Kodit Zgjedhor. Në fakt, për nëpunësit civilë ne kemi pasur një diskutim, sepse ka nëpunës civilë që kanë kandiduar në zgjedhjet e kaluara dhe mandej u kthyen në detyrë ndërkohë që kjo është një çështje për t'u diskutuar, sepse nuk është mbajtur i njëjti qëndrim për të gjithë. Nëse një kategori të gjerë nëpunësish që nuk janë nëpunës civilë, ti ua kushtëzon kandidimin me heqjen dorë përfundimisht nga detyra (jo vetëm ushtarakëve, por edhe të tjerëve), atëherë duhet parë nëse edhe për nëpunësin civil, a është e njëjta gjë. Është paradoksale që për periudhën e kandidimit je person politik dhe fill mbas kandidimit, nuk ke më lidhje me partinë politike. Kjo histori nuk shkon.

Ose koha e regjistrimit, që vjen këtu menjëherë, a është reale? Ne nuk e kemi respektuar kurrë. Çdo parti politike do të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve. Këtë nuk e kemi respektuar dhe Kodi Zgjedhor, natyrisht si çdo ligj nuk e parashikon se çfarë ndodh, kur ti nuk e respekton atë që ke shkruar, sikundër te gjërat që kemi folur për kuotën gjinore. Thuhet 30%, por mekanizmi nuk është i tillë që të sigurojë 30-përqindëshin, sepse ai mekanizëm nuk ka valvul sigurie. Ne hidhemi direkt te shifra 50%, kur në fakt nuk kemi arritur realisht 30-përqindëshin. Nuk po flas teorikisht, por realisht. Në teori e kemi në rregull.

Le të ecim sipas këtij rendi, me qëllim që edhe ekspertët të njihen me mendimet dhe optionet tona për secilën prej çështjeve, në mënyrë që ata të mund të na ofronin modele të ndryshme dhe pastaj ne të zgjidhnim. Unë mendoj se kështu do të kishte më shumë kuptim.

Natyrisht, ne nuk jemi njohës të çdo modeli, sepse nuk është kjo detyra jonë, por duke shfaqur secili nga ne dyshime për pika të caktuara që përmban kjo pjesë e kodit, se nuk po marrim të gjithë kodin në revizionim, por po shohim sot këtë pjesë të kodit, që fillon nga regjistrimi. Kjo nuk ka fare lidhje me sistemet (maxhoritare, proporcionale apo të tjera). Besoj se kështu, do të mund të nxjerrim diçka.

Kjo do të na evitonte edhe debatin e kolegëve për të cilin unë do t'u jepja të drejtë të dy kolegëve, edhe kolegut Mediu, edhe kolegut Rama, që këto mbledhje të mos bëhen të mërzitshme dhe ne të jemi pasivë dhe thjesht të dëgjojmë, se i gjithë reagimi për këtë ishte. Nëse jemi në këtë komision, natyrisht, duam të kemi rol aktiv në këtë pjesë. Kështu, duke ndjekur një

rend të caktuar bëhet e mundur kjo, por nëse shpërndahemi, mua më duket se nuk është e mundur.

Këtë propozim shumë dashamirës e kisha për të gjithë kolegët, kështu që le të ndjekim një linjë më sistematike dhe të jemi më të koncentruar në gjërat që themi, në mënyrë që në fund të dalim me një produkt.

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Po, zoti Ndoka.

Nard Ndoka – Faleminderit!

Ne kemi pesë shqetësime serioze ...

Luan Rama – Bashkim, qëndro të dëgjosh edhe Nardin!

Nard Ndoka – Unë mendoj se problemi kryesor i zgjedhjeve mbetet sistemi. Pavarësisht se nuk është momenti, për ne është elementi kryesor që duhet diskutuar, për faktin se mund të vendosim shumë gjëra dhe në varësi të sistemit, shumica e tyre mund të bien poshtë.

Pra, kjo është koka e reformës zgjedhore. Është e domosdoshme të ketë një konsensus politik. Nuk e di si janë negociatat midis bashkëkryetarëve për këtë çështje, por besoj se duhet të jetë preokupimi kryesor juaji dhe i *OSBE-ODHIR*-it. Ne gjykojmë se është një sistem problematik, antikushitetues në përfaqësim dhe diskriminues.

Problem tjetër janë koalicionet, sepse ka pengesa reale për to. Ato parti politike, që nuk dëshirojnë të futen në një koalicion politik, penalizohen me përqindjet e përfaqësimit si dhe me probleme të tjera në aspektin financiar.

Pra, partitë politike që futen në një koalicion me një sigël partie, siç ishte rasti i zgjedhjeve të fundit, penalizohen nga mbulimi financiar për aktivitetin normal të një partie politike pikërisht prej pengesave që ne kemi vendosur në Kodin Zgjedhor. Gjykoj se duhet të rishikohen.

Problem tjetër janë listat e zgjedhjeve. Me të vërtetë ne flasim për disa elemente të përfaqësimit apo të demokracisë, por unë nuk gjykoj se kjo bëhet nëpërmjet listave apo sanksioneve që ne kemi vendosur në ligj.

E para, kemi bërë një regres jashtëzakonisht të madh në zgjedhjet lokale duke vendosur përfaqësimin 50 me 50. Madje ajo nismë ishte edhe një lloj talljeje, sepse gratë kërkuan të përfaqësoheshin 30%, kurse ne e vendosëm 50%. Tolerancë e madhe e rilindësve në ato momente...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ishte interesante, sepse kërkesa ishte për 30%, kurse Komisioni i Ligjeve i asaj kohe vendosi të jetë 50%.

Ne kemi prishur cilësinë e përfaqësimit. Pra, detyrojmë vendosjen e grave, kurse burrat e tyre duhet të bëjnë fushatën. Disa parti politike janë në vështirësi edhe për plotësimin e listave formale me gra. Pra, kemi vendosur diçka artificiale në përfaqësim dhe jashtëzakonisht problematike në funksionimin e këshillave. Prej kësaj gjëje është ulur niveli i cilësisë dhe kanë dalë shumë probleme të tjera. Do të ishte shumë interesante që partitë politike në ... Sidomos dy partitë kryesore ...

Pesha kryesore është juaja, kurse partitë tona janë larg këtyre pengesave. Nëse ju krijoni hapësira konkurrimi brenda këtyre partive, përfshirë edhe tonat (ndryshimi në kod ka ardhur prej jush, sepse partitë tona nuk kanë mundësi të zgjedhin të gjithë listën që dorëzohet për deputetë), besoj se kjo do ta çlironte nga ky realitet i trishtueshëm. Për gratë ky është diskriminim, pavarësisht se duket si diskriminim pozitiv. Është diskriminim kur ne caktojmë kuotat, se do të jenë kaq gra në parlament. Ne e shikojmë edhe në jetën e përditshme. Gratë që kemi në parlament nuk janë aq aktive, përfaqësuese dhe nuk llobojnë me njëra-tjetrën për interesa të ndryshme partiake, përkundrazi, disa gra bëhen edhe më burrë se burrat. I kemi pasur edhe në drejtimin e parlamentit. Pra, nuk ulin konfliktin politik apo japin një kontribut të dukshëm në jetën parlamentare apo qeverisjen e vendit.

Kështu që, unë gjykoj që të paktën të bëhet një rishikim i listave për zgjedhjet lokale. Të jenë me të njëjtat parametra me zgjedhjet parlamentare. Është hap i nxituar dhe nuk ka pse të mos e riparojmë, sepse realisht ka krijuar shumë probleme.

Tjetër problem është pengesa në regjistrim. KQZ-ja është një institucion që vetëm kur përballen partitë politike në regjistrim, fillon pengesat duke filluar me financimet. Financën disa parti politike që nuk i kalojnë përqindjet e përfaqësimit dhe u vendos kushte disa partive të tjera politike. Disa parti politike janë përballuar në gjykatë për shkak se nuk kanë mundur të regjistrohen në zgjedhje. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është një institucion që i informon në vazhdimësi partitë politike dhe nuk bëhet pengesë për mosregjistrim në zgjedhje. Pjesa që duhet t'i rikthehet buxhetit të shtetit nuk duhet të jetë pengesë. Në momentin që kjo parti politike financohet, në bazë të ligjit mund të ndalohet në vazhdimësi, por jo duke e penguar atë për të

marrë pjesë në zgjedhje. Besoj se atributi i KQZ-së për të penguar disa parti të regjistruhen në zgjedhjen duhet hequr si element, sepse nuk është i ligjshëm.

Problem tjetër janë komisionet.

Ne flasim për shumë gjëra, por komisioni është gangrena e këtij sistemi. Ka një klimë mosbesimi midis dy partive kryesore politike. Kur është PD-ja në pushtet, PS-ja nuk pranon të ketë një trupë zgjedhore të depolitizuar, kurse tani është e kundërta. Besoj se ka ardhur momenti të shkëputemi nga komisionerët partiakë, sepse janë gangrena e zgjedhjeve. Çdo element që ne rregullojmë në Kodin Zgjedhor Nëse vazhdojmë të lejojmë që administrimi i zgjedhjeve të bëhet nga përfaqësuesit e partive politike, devijimi dhe tjetërsimi i votës do të jetë një problemi i madh i vjedhjes së votës.

Prandaj, ka ardhur momenti që ne të gjejmë një formulë, ndoshta të marrë prej vendeve me një demokraci më të konsoliduar se yni. Jemi i vetmi vend...

OSBE-ODHIR-in e mbajnë si një model, por nuk e kuptoj pse nuk ka një këmbëngulje drastike, sepse vetëm Shqipëria i zhvillon zgjedhjet me përfaqësuesit e partive politike.

Ne jemi të penalizuar. Partitë që nuk kanë përfaqësues në komisionin e zgjedhjeve janë të penalizuara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga tjetërsimi dhe vjedhja e votës si në zgjedhjet parlamentare, ashtu edhe në zgjedhjet lokale.

Partia që ka pushtetin mund të blejë edhe komisionerët e opozitës. Përtej problemit të partive të vogla, edhe partia që është në opozitë, ka një trysni të drejtpërdrejtë nga komisionerët, aq sa dy partitë e mëdha politike nuk i trajnojnë komisionerët, por dërgojnë lista fiktive nga frika se mos ia blejnë komisionerët njëra-tjetrës. Gjithashtu, kthejnë edhe afatet ligjore.

Këto parti nuk i kanë të trajnuar fare komisionerët për faktin se i dërgojnë listat në momentet e fundit të afateve kohore dhe i zëvendësojnë kur kanë informacione që komisionerët janë blerë. Imagjino çfarë produkti do të kemi për administrimin e këtyre zgjedhjeve.

Kërkesë imja kryesore është që të gjendet një mundësi konsensusi midis palëve.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Ndoka!

Fjalën e ka zoti Alibeaj dhe më pas zoti Mediu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Do t’i bie shkurt. Do të doja që për secilën nga pesë çështjet, nëse ekspertja ka ndonjë opinion të vetin, le ta thotë, me idenë që ky material të shërbejë për t’u hapur ekspertëve diapazonin teksa diskutojnë çështjet dhe draftojnë këtë problematikë.

E para, historia e kuotave më duket një hipokrizi totale. Kam përshtypjen që thelbi nuk është te vendosja, me dhunë ndonjëherë, e barazisë së kuotave. Në fakt, në logjikë do të duhet të jetë barazi shansesh, që është diçka tjetër edhe në logjikë matematike. Kjo do të ishte më e sinqertë.

E kuptoj që ky është një ndryshim i madh i filozofisë së përdorur deri tani, por më mirë të ecim me idenë e barazisë së shanseve sesa të vendosim në mënyrë hipokrite disa kuota, të cilat, rrugës, duke qenë se nuk i qëndrojnë presionit, na ndodhin historitë e kapërcimeve. Gratë janë në listën që prezantohet në KQZ, ndoshta edhe zgjidhen, por ka pak gjasa të ulen në parlament.

Mund të ishte një rregull, që nëse një nga palët politike vendos në listën iks një numër të caktuar grash, të tjerat do të ishin të detyruara ta respektonin. Kjo është barazi shansesh.

Të tjerat i kam çështje që lidhen me procesin e ankimimit dhe të apelimit. Unë e mora vesh që eksperti ka humbur avionin, por, gjithsesi, po i ngre këtu si çështje dhe nëse zonja ka ndonjë opinion mirë do të ishte të na e thoshte.

E para, proceset zgjedhore janë garë. Ndodh gjithmonë të ketë të humbur nga kjo garë dhe është njerëzore që pjesa e humbur të qahet, me apo të drejtë. Deri këtu qëndrojmë te dyshimet për parregullsi në zgjedhje. Pak kohë më vonë, një ose dy muaj më vonë, ndodh që këto pretendime që ngre pala humbëse, bëhen më serioze nga raportet respektive të *OSBE-ODIHR*-it. Kështu ka ndodhur në Shqipëri.

Pyetja që unë kam është kjo: me aq sa ju keni analizuar sistemin e apelimit dhe të institucioneve respektive, KQZ-në plus sistemin zgjedhor, a mendoni se ky sistem është i aftë, ka kapacitete, ka autoritet, ka mjete, ka instrumente në dorë, që, në qoftë se ndodhin shkelje ose parregullsi para fushatës, gjatë fushatës dhe gjatë procesit të individualizimit të rezultatit, ky mekanizëm, që vepron *post factum*, të ketë mundësi dhe kapacitete të plota që shkeljet t’i penalizojmë duke vendosur drejtësi, apo jo?

Së dyti, në një nga *slide*-et që ju paraqitët, pashë se ju ishit për një zgjedhje që çështjet e ankimimeve të mos eksplorojnë fillimisht rrugën administrative pranë KQZ-së, por të shkojnë drejtpërdrejt në sistem gjyqësor, pra në gjykatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Harrojeni këtë.

Së treti, që tani u bë e dyta, sot ne kemi një sistem, ku administrimi i zgjedhjeve bëhet nga një trupë administrative, që është KQZ-ja, e cila ka detyrimin t'i organizojë ato në bazë të ligjit, në korrektesë strikte me ligjin, që do të thotë se duhet të japë një shërbim ndaj individëve dhe t'u garantojë atyre të drejtën e votës. Ky është një shërbim. A jeni ju për alternativën, që përgjatë segmentit të ankimimeve, apeliemeve në sistemin gjyqësor, të ndodhë një përmbysje e barrës së provës?

Sot, në Shqipëri ndodh që kandidatët e secilës parti, stafet e tyre, përveç faktit që duhet të bëjnë fushatë dhe të bindin njerëzit, ata i rezervojnë veprimtarisë së tyre edhe një lloj sfondi që të veprojnë edhe si investigatorë për të gjetur se ku janë provat e shkeljes së procesit zgjedhor, me idenë se pas rezultatit t'i paraqesin në sistemin gjyqësor, gjë që nuk është e natyrshme, por kështu ndodh. A nuk do të ishte e udhës që faza e shqyrtimit gjyqësor të jetë e strukturuar midis atyre që marrin shërbimet, që janë palët politike, dhe atyre që ofrojnë shërbimin, administrata zgjedhore, ku kjo e dyta të ketë detyrimin të provojë para gjykatës që procesi zgjedhor ka qenë i rregullt dhe kjo është një lloj përmbysjeje e barrës së provës?

E fundit, nëse e keni marrë në analizë, gjithmonë nëse, çështjen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, logjika e përdorur sot në Kodin Zgjedhor është një logjikë e thjeshtë matematikore. Nëse simptoma, defekti që ka një proces zgjedhor afekton rezultatin zgjedhor në terma numerikë, zgjedhjet mund të deklarohen të pavlefshme, nëse jo, pra edhe nëse ata ekzistojnë, ka defekte dhe parregullsi, por masa e votave nuk kapërcen diferencën mes palëve, ato nuk shpallen të pavlefshme. Kjo logjikë ecën duke e konsideruar procesin zgjedhor si garë mes palëve, mes subjekteve dhe mes partive politike, por që procesi zgjedhor nuk është vetëm garë mes palëve, mes partive politike, por është edhe një proces, i cili duhet të garantojë votën e individit, votën e zgjedhësit. A jeni ju gati për të kaluar në një mekanizëm tjetër logjik dhe juridik, që të mos jetë si kriter vetëm çështja e masës, por të jetë edhe çështja e cilësisë dhe nëse vota e një grupi dhe

një individ nuk është e garantuar, pavarësisht se sa influencon te rezultati zgjedhor, të mund të ketë mundësi që të veprojë sanksioni i pavlefshmërisë së zgjedhjeve?

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Zonja Schmidt do t'u japë përgjigje disa prej pyetjeve, por procesi mbetet i hapur dhe është një proces që do të vazhdojë me shkëmbimin e ekspertizës së opinionëve.

Nicola Schmidt – Faleminderit për këto pika shumë të posaçme dhe falënderoj edhe folësit e mëparshëm, të cilët ngritën disa çështje që dua t'u përgjigjem.

Lidhur me ankesat, fatkeqësisht eksperti, i cili është marrë me këtë çështje, nuk është këtu, por ne mund t'ju ofrojmë më shumë informacion në një fazë të mëvonshme.

Do të përpiqem të trajtoj disa nga çështjet e ngritura, që kanë të bëjnë me procesin e përgjithshëm të ankesave apo apelimeve, janë të posaçme, por edhe mjaft të thjeshta, sepse kanë të bëjnë me zgjidhje të efektshme dhe në kohë me afate të shkurtra dhe me sistem të qartë ankesash. Aktualisht, duhet ta pranoj se sistemi në Shqipëri më duket i ndërlikuar, jo vetëm mua, por edhe të tjerëve. Prandaj unë mendoj se duhet të ketë sqarime të procedurave.

Një pikë e rëndësishme që ju përmendët, lidhej me shqyrtimin gjyqësor. Kjo nuk vlen për çdo ankesë, por duhet të ekzistojë mundësia e apelimit të një vendimi që merret nga KQZ-ja në lidhje me një ankesë dhe të ketë mundësi apelimi të këtij vendimi në gjykatë. Nëse ekziston mundësia e shqyrtimit gjyqësor, e njëjta gjë vlen edhe për vendimet e Kolegjit Zgjedhor.

Në lidhje me vendimet, që kanë rëndësi të madhe për zgjedhjet, mendoj se kjo ka pasur keqkuptime. Për shembull, kur KQZ-ja vendos për rezultatet, duhet të ekzistojë mundësia që të apelohe ose të ankohe kundër këtij vendimi direkt në kolegji, sepse logjika është që, kur shikon mënyrën se si miratohet vendimi për rezultatin, shumica që nevojitet në KQZ dhe shumica që nevojitet nga KQZ-ja për të rënë dakord në një ankesë më vonë është e pamundur që nga përbërja numerike KQZ-ja të ndryshojë atë vendim që ka marrë një herë me aq vetë. Pra, rekomandimi do të ishte që të shkohet direkt te kolegji, e cila përputhet dhe rekomandohet nga standardet ndërkombëtare.

Lidhur me çështjen e fazës së shqyrtimit gjyqësor dhe me barrën e provës, nëse e kuptova mirë, kishit çështjen ndërmjet gjykatës dhe pritjes për të marrë shërbimin nga... Këtë e shikoj si perspektivë të votuesit për të pasur të drejtën për të votuar qeverinë, parlamentin dhe

përfaqësuesit e tij. Në fakt, gjithçka duhet strukturuar rreth kësaj të drejte. Kështu që, edhe KQZ-ja, edhe gjykatat janë dhënë të shërbimit ndaj votuesit, duke qenë se janë votuar në parlament. Kjo është perspektiva e bazuar mbi të drejtën që unë e shikoj.

Gjithashtu, nëse e shohim fazën e rishikimit ligjor, ai nuk duhet jetë vetëm ndërmjet administratës dhe atyre që u janë shkelur të drejtat, por gjithmonë duhet të jenë të përfshirë gjykata dhe gjyqësori, pavarësisht se te gjyqësori kemi një nivel tjetër të rishikimit të ankesës në momentin kur vjen kjo ankesë te gjyqësori. Kjo është baza dhe justifikimi për rekomandimin që këto mundësi të jenë të hapura për të gjithë, jo vetëm për kandidatët e partive, por edhe për votuesit individual, sepse, në fund të fundit, rezultati i zgjedhjeve prek votuesin individual. Ankesat duhet të jenë të arsyeshme dhe të kenë mundësinë e dhënies së dokumentacionit pse po ankohet dikush, por nuk kanë pse ta vërtetojnë. Barra e provës nuk duhet të jetë te ankimuesi, por ankimuesi duhet të jetë i përgjithshëm. Duhet të ketë një bazë për këtë ankim dhe trupa që merret me ankesën, qoftë KQZ-ja, Kolegji Zgjedhor apo një gjyqësor tjetër të merren me këtë ankesë. Ne duhet të kemi një bazë kur ta fillojmë punën dhe, kur vjen puna te zhvlerësimi i zgjedhjeve, duhet të bëjmë hetimin e çështjes. Ndoshta nuk e kuptova diçka që thatë në mënyrë të drejtë, por mendoj mënyra se si është rezultuar në Kodin Zgjedhor duhet të ketë një mundësi dhe mendoj se është aty për të deklaruar një zgjedhje të pavlefshme për zona të caktuara nëse ka pasur shkelje procedurale apo çështje të caktuara me votimin apo votuesit. Kjo nuk lidhet me faktin vetëm nëse ka pasur një influencë te rezultati, por duhet të ketë bazë për atë që jepet në ligj dhe, nëse ka një zhvlerësim, të mos bëhet vetëm nëse kjo ka pasur një ndikim mbi shpërndarjen e përgjithshme të mandateve, por në bazë të situatës, në qendra të caktuara votimi apo në zona të caktuara. Kjo për sa u përket ankesave dhe apeleve.

Gjithashtu, dua t'u jap përgjigje disa çështjeve që janë ngritur për sa i përket, sistemit të listave, kuotave dhe dekriminalizimit.

Besoj se e dini që ODIHR-i nuk rekomandon një sistem të caktuar zgjedhor, është në dorën e vendit se cilin sistem do të zgjedhë. Kur vjen puna te lista e kandidatëve, veçanërisht te përfaqësimi i grave, duhet marrë një vendim dhe ju këtë e keni marrë në Shqipëri, për të pasur sistemin e listave të mbyllura, ku partitë regjistrojnë listat, më pas duhet t'u përmbahen disa kuotave, por nuk kanë mundësi që votuesit të ndryshojnë listën. Në demokraci kjo është e drejtë, po e patët një sistem të tillë, sepse është e njëjta në Gjermani. Për shembull, ne nuk mund ta

ndryshojmë listën. Nëse shikon vendet e tjera, si, për shembull, Zvicrën apo Islandën, aty votuesit mund të ndryshojë renditjen e kandidatëve në listë. Patjetër, nëse keni një sistem të tillë, ku votuesit mund të ndryshojnë renditjen e kandidatëve në listë, atëherë nuk ka vlerë që të ketë një sistem kuotash në vend. Ju mund të keni një sistem kuotash, por patjetër që votuesi mund të ndryshojë renditjen. Është në dorën tuaj për të vendosur se çfarë do të bëni, por këto janë dy parime kundërshtarë më njëra-tjetrën, pra ideja e pasjes së një procesi vendimmarrjeje të brendshëm në parti apo e anëtarësisë së partisë, që vendos se kush janë kandidatët për partitë. Për shembull, në Gjermani është një sistem ndryshe. Patjetër kjo do të vendosë kërkesat ligjore mbi një parti se si ato do të dalin me listat e kandidatëve. Kjo është diçka që ju mund ta konsideroni, por nuk është një rekomandim konkret për t'u bërë. Patjetër që mund të vazhdoni me sistemin që keni tani, por rekomandimi im do të ishte që të siguroheni që ajo që është në legjislacion të zbatohet dhe të implementohet. Patjetër, ka një përfaqësi grash, dhe në fund do të ketë sanksione për partitë që nuk e përmbushin këtë lloj rregulloreje. KQZ-ja mund të bëj diçka për sa i përket partive që nuk e përmbushin këtë legjislacion.

Për sa i përket dekriminalizimit, përsëri keni një ligj në vend të vendosur për dekriminalizimin dhe keni një rregullim për sa i përket asaj se kush mund të jetë kandidat dhe kush mund të zgjidhet në bazë të këtij legjislacioni. Përsëri, mendoj se është faza e implementimit të zbatimit të legjislacionit dhe të sigurohemi që ata të bien në ligjin e demikriminalizimit të mos jenë kandidatë ose të mos jenë në listat e kandidatëve, dhe më pas të mos instalohen, të mos vendosen në zyra të zgjedhura. Për mua është në më shumë çështje implementimi dhe zbatimi në vende të legjislacionit të ri. Gjithsesi është në dorën tuaj që ta diskutoni dhe të futeni më në detaje për këtë.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zonja Nicola!

Urdhëroni, zoti Mediu!

Fatmir Mediu – Faleminderit!

Në dijeninë time, unë di se jemi republikë parlamentare dhe jemi demokraci përfaqësuese. Në Kushtetutë kemi të shkruar: “Çdo individë, në moshën 18 vjeç, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet” jo çfarë i hedhin, por “të zgjedhë dhe të zgjidhet”. Problemi që kemi sot, nga pikëpamja dhe këndvështrimi im për organizimin dhe funksionimin e parlamentit, është se

nga një organ i zgjedhur, e kemi kthyer në një organ pothuajse të emëruar. Unë mendoj se kjo në thelb cenon kushtetutshmërinë, autoritetin e Kuvendit, dhe në elementin fundor të tij, të drejtën e qytetarëve për të pasur përfaqësuesit e tyre në Kuvend.

Sot me keqardhje mësova se Gjermania dhe Amerika nuk janë vende demokratikë, sepse nuk kanë kuota. Në zgjedhjet e fundit presidenciale në Amerikë kandidatja ishte një grua, kurse në Gjermani kancelaria, për një kohë të gjatë, po është një grua. Pra, njerëz që kanë ditur të konkurrojnë dhe të fitojnë për nivelet më të larta. Mbase me këtë logjikë, të rritjes së kuotave këtu, do t'i propozojmë se herë tjetër po kandidoi Hilari Klinton, të mos kandidojë kandidati tjetër republikan, sepse duhet apriori ta fitojë presidencën një grua. Shembulli gjerman dhe ai amerikan më kanë mësuar që demokracia është konkurrim dhe demokracitë përfaqësuese, qoftë ky kongres, Bundestag apo parlament, janë zëri i qytetarëve në mënyrë të drejtpërdrejtë për atë çfarë zgjedhin ata. Meqenëse u ngrit këtu edhe shqetësimi se sistemi mund të përjashtojë kuotën, sugjeroj për vlerësim, në qoftë se ka eksperiencën të tilla, duke bërë një krahasim me parlamentin tonë, në qoftë se ka 140 vende në parlament, a mund të gjejmë ndonjë variant, që 70 kandidatë të konkurrojnë burra me burra dhe 70 kandidatë të konkurrojnë gra me gra, ose për 70 vende të parlamentit të kemi konkurrim dhe për 70 vende të parlamentit t'i kemi vetëm kuota për gra, meqenëse konkurrimi mund të sjellë dhe gra të tjera, dhe e tejkalojmë planin e 50%-shit. Mund të ketë ndonjë variant të tillë, që ta shikojmë? Meqenëse ka një vullnet shumë të mirë nga partitë e mëdha për këtë çështje, dua të sugjeroj, si një mundësi për përfaqësi me kuota, në bazë të financimit që marrin partitë e mëdha dhe në bazë të kohës mediatike aq sa para marrin, aq sa kohë mediatike kanë, në përqindje t'ju vendoset edhe kuota për gra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, t'i shikojmë se cilët janë këta shembuj europianë demokratikë, të cilët të drejtën e individit e kanë vendosur nën të drejtën e grupeve, qofshin këto gjinore, etnike apo të interesave të tjera. Flas në këndvështrimin tim politik, ku liria dhe e drejta janë thelbësore, janë shumë më thelbësore se sa organizime të caktuara për t'ju mbivendosur të drejtës.

Të nderuar bashkëkryetarë, kam dhe një moment të dytë për vlerësim për OSBE-ODIHR-in, për ne dhe për grupin e ekspertëve. Një nga shqetësimet kryesore për zgjedhjet është shitblerja e votës. Ne kemi shkuar te penalizmi i atyre që shesin votën dhe atyre që blejnë votën, por nuk kemi asnjë penaltet për kandidatin përkatës apo për subjektin përkatës. Ti mund të blesh

20% të vendeve në parlament, mund të shkosh në proces gjyqësor, që zgjasin pafund, për individ të ndryshëm të përfshirë në këtë proces dhe ti gëzon mandat të plotë 4-vjeçar, si subjekt, dhe asnjë gjë nuk i ndodh as kandidatit dhe as subjektit. Pra, qoftë në rastin që ngriti zoti Alibeaj, të anulimit të procesit të votimit apo të ndëshkimit të kandidatit, që vjedh apo të subjektit, a ka mundësi që brenda elementeve ligjor, duke respektuar të gjitha të drejtat ne të shikojmë dhe mundësinë e penalizimit të subjektit apo të kandidatit, që manipulon dhe blen zgjedhjet? Ky është një sugjerim që ekspertët ta shikojnë, por do t'ju lutem, meqenëse sot mësova që Gjermania dhe Amerika nuk janë vende demokratike, sepse nuk kanë kuota, për ato sugjerime që bëra, dua ndonjë shembull europian se si mund ta zgjedhim problemin e çështjes së kuotave me mënyrën dhe sugjerimet që dhashë.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Mediu!

Me dakordësinë tuaj, ne kemi parashikuar në axhendën e sotme që, pas drekës, të jetë një sesion konkluzionesh, por besoj se çështjet u ezauruan dhe besoj se kemi mundësi t'i bëjmë konkluzionet para ndërprerjes. Kështu që, me dakordësi, e vazhdojmë në këtë formë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani në cilësinë e anëtarit të këtij komisioni, jo të bashkëkryetarit të këtij komisioni, dua të shpreh mendimin për 2-3 çështje, nga ato që u diskutuan deri tani.

Në lidhje me çështje e kuotave, OSBE-ODIHR-i nuk ka pasur rekomandime fillimisht për Kodin Zgjedhor derisa në vitin 2008, në mënyrë të vullnetshme, komisioni i reformës vendosi për herë të parë kuotat. Pra, deri atëherë nuk kishte. Jo vetëm kaq, por kuotat, si mekanizëm diskriminimi pozitiv, konsiderohen nga Komisioni i Venecias dhe nga OSBE-ODIHR-i, duhet të jenë normalisht dispozita transitore, jo të përhershme. Megjithatë, ne kemi zgjedhur rrugën e përhershme. Ajo që kemi zgjedhur atëherë ka qenë dhënia e mundësive të barabarta për të dyja gjinitë dhe më pas hapësirë kompeticioni për të dyja gjinitë. Unë besoj se është e rëndësishme ruajtja, pra nuk duhet të rendim drejt kuotave të tjera, në dëm eventualisht të kompeticionit. Në shembujt që u sollën më herët, vura re diçka që ne nuk e kemi, kuota është për gjininë e papërfaqësuar. Ne sot kemi kuotë të njëjtë për të dyja gjinitë, pra kuotën e kemi neutrale. Kjo është diçka që duhet parë më tutje. Por rendja në një kuotë edhe më agresive, ndërkohë që nuk kemi zbatuar në mënyrë efikase këtë që kemi, mund të dënojë kompeticionin, në këndvështrimin tim. Sot kemi një sistem të përshkallëzuar, kemi vënë kuotë 50% në nivelin

lokal, me refuzim të listës kemi një kuotë 1 në 3 të parët dhe 30% e listës, në zgjedhjet parlamentare. Në zgjedhjet parlamentare kemi sanksion financiar, i cili nuk është e vërtetë se nuk ka funksionuar, sepse shpeshherë kanë qenë sanksione të rënda, por me sa duket mbetet joefikas.

Së pari, për sa i përket sanksionit, diskutimi mund të jetë, nëse e bëjnë më efikase kuotat aktuale, duke vënë një sanksion të tillë, si refuzimi i listës. Pra, partitë politike duhet të mendohen dy herë nëse nuk do ta respektojnë atë kuotë që përcakton ligji.

Së dyti, çështja tjetër që unë shtroj për diskutim, pra për të marrë mendim nga ekspertët është: ne kemi 50% gra dhe 50% burra në zgjedhjet lokale. Kjo do të thotë se është një ambient kompeticioni dhe kontributi politik, i cili i mundëson një numri të madh grash ose burrash për t'u marrë me politikë, më pas ato që filtrohen si kualitete politike, përfaqësuese brenda partive, konkurrojnë dhe jo vetëm kanë garancinë e kuotës, por e kalojnë kuotën dhe marrin më shumë se 30%. Pra, besoj se, në vend që të rendisim se cila është kuota më e madhe, ne duhet të garantojmë barazinë e shanseve. Kjo duhet të jetë solide, e garantuar me sanksione efikase, më pas të mendojmë sesi kjo, edhe nëpërmjet kuotave brenda partive politike, të detyruara ndoshta edhe me ligj, të bëhet gjithmonë e më funksionale. Pra, duhet ta shohim si një proces, i cili, në fakt, nga viti 2008 deri më sot ka sjellë një përmirësim të dukshëm të numrit të grave në parlament dhe në këshillat vendorë.

Nuk do të hyj te çështja interesante e rregullimit me ligj të mënyrës së zgjedhjes së kandidatëve. Ky mund të jetë një opsion, por është diçka që duhet të kombinohet me sistemin.

U trajtua çështja e dekriminalizimit. Besoj se duhet të kemi një këndvështrim të hapur. Ende nuk e kemi mbyllur problemin. Efektivisht ka persona, të cilët kanë rekord kriminal, që janë shmangur nga funksione publike, por ushtrojnë presion në fushatë. Kjo do të thotë që duhet të shohim nëse duhet ta shtrijmë më tej në ligjin e partive politike, nëse duhet ta vëmë standard në Kodin Zgjedhor. Problemi mbetet. Nuk besoj se ne e kemi mbyllur dhe ky komision duhet të ketë mundësinë ta zgjidhë këtë çështje. Nëse do të ketë penalizim edhe të kandidatëve, besoj se mund të jetë një opsion. Për shembull, ka vende ku kandidati mund të humbasë edhe mandatin. Në dijeni time, mund edhe ta kem gabim, ka penalitete për kandidatin kur provohet që financimi ka pasur probleme.

Ajo është një paligjshmëri. Këtu përsëri kemi një ushtrim kriminal në fushatë, në marrjen e atij mandati, prandaj duhet të shohim se cilat janë këto zgjedhje.

U ngrita edhe në fillim çështjen e rolit të policisë në zgjedhje, por ne nuk e trajtuam. Shkuam nga një polici agresive në procesin zgjedhor në vitin 2000-2001 në një polici që është totalisht e papërfshirë në proces, duke lënë hapësira për kriminelët në proces. Ky është një moment shumë delikat, sepse policia mund të kthehet po aq në problem nëse rikthehet, por ne sot nuk kemi më një kornizë ligjore që disiplinon mënyrën si funksionon policia. Dikur ka qenë në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, sot nuk është më. Për rrjedhojë, mundësia e abuzimit, për hir të mbrojtjes së procesit zgjedhor, mbetet e lartë dhe ne duhet ta shohim këtë pjesë.

Për ta mbyllur, po jap disa këndvështrime personale në lidhje me ankimet. Formaliteti në gjykimin e ankimeve, në fakt, ka ardhur si praktikë e KQZ-së. Ka qenë një vendimmarrje e hershme e Komisionit të Reformës që procesi i ankimit nuk duhet të jetë formal. Për fat të keq, kjo situatë është renduar. Kështu që ose duhet të gjejmë një zgjidhje që e qartëson, ose duhet të shohim se cila është zgjidhja për këtë çështje. Por subjektet duhet të kenë mundësi që jo vetëm të bëjnë ankim, duke eliminuar ankimet e tepërta dhe të kota, por, me të drejtë, shtrohet çështja e barrës së provës. Shpeshherë subjektet nuk e kanë provën. Prova gjendet në kutinë e votimit, në kutinë e materialit zgjedhor, dhe nuk kanë mundësi ta kenë këtë akses. Një KQZ hiperformaliste do të çonte në rrëzimin e shumë prej ankesave, të cilat mund të jenë të vërteta, por që është e pamundur që ankuesi t’i provojë vetë drejtpërdrejt. Mungesa e të drejtës së zgjedhësve për t’u ankuar është një problem jo vetëm në aspektin e praktikës së mirë apo të standardeve, por është problem real. Ne sot kemi qendra votimi, të cilat janë të panumëruara, sepse janë shpallur të panumërueshme, për të cilat nuk ka vendim nga KQZ-ja. Askush nuk është ankuar. As KQZ-ja nuk ka marrë një vendim për ta hetuar kryesisht çështjen për interes të publikut, sepse është garanti i vetëm i publikut sot, madje asnjë parti politike nuk e ka bërë këtë ankim. Ne kemi të paktën dy raste që janë kuti, të cilat nuk përfshihen dhe nuk dihet nëse ishin për pavlefshmëri apo mund të rinumëroheshin. Nëse kjo është në një numër më të madh, siç ka qenë rasti i qendrave të votimit në vitin 2009, kur një numër qendrash votimi nuk u hapën, por nuk pati as vendimmarrje për pavlefshmëri nga KQZ-ja, sepse askush nuk u ankua.

Po e mbyllim me çështjen e pavlefshmërisë. Ndërkohë që kemi ecur dhe kemi bërë një rrugë jo të keqe në këtë aspekt (unë jam dakord me atë që tha ekspertja e ODIHR-it, që besoj se e ngriti edhe zoti Alibeaj), ne duhet të bëjmë një shkëputje nga kriteri numerik që çon drejt pavlefshmërisë së të gjithë zonës dhe përsëritjes së zgjedhjeve dhe nga shkeljet, të cilat ndikojnë

në degradimin e rëndë të një procesi zgjedhor në një qendër specifike votimi. Nuk mund të lëmë në tabelën e rezultatit qendra votimi, të cilat kanë një rezultat të kalbur që është i panumërueshëm. Kjo mund të jetë shpeshherë numerikisht e matshme, por mund të jetë edhe rast unik.

Kujtoj se ekspertët e ODIHR-it në vitin 2002 sollën rastin e një ministreje austriake, e cila kishte tentuar të votonte në vendlindjen e saj, ndërkohë që ishte e regjistruar zyrtarisht në listat e Vjenës. Nuk e dinte faktin; ushtroi presionin si ministre dhe u lejua të votonte nga komisioni i qendrës së votimit dhe Gjykata Kushtetuese austriake e gjeti këtë si shkelje të ligjit nga komisioni, me potenciale për t'u përsëritur në një masë më të madhe, duke sjellë pavlefshmërinë e qendrës së votimit. Ky ishte një shembull shumë sinjifikativ. Ndoshta sistemi ynë nuk është në gjendje të arrijë deri në këtë nivel, por ne duhet të jemi të kujdesshëm që qendra votimi, në të cilat është e provueshme që nuk kanë pasur zgjedhje dhe ajo që është brenda nuk janë fletëvotimi të rinumurueshme, por është thjesht diçka që nuk ka vlerë juridike, kështu që të shpallet e pavlefshme. Këto ishin çështjet që unë kisha ndër mend të ngrija.

A do ndonjëri të japë ndonjë kontribut tjetër përpara se të shkojmë drejt konkluzioneve, pra jo jashtë Komisionit të Reformës? Nuk ka.

Ne do t'ju dërgojmë një raport të përmbledhur të diskutimit që u zhvillua në mbledhjen e sotme. Gjithashtu, procesverbali i mbledhjes do të zbardhet si një mbledhje standarde e komisionit, pra kush të dojë, mund ta konsultojë për më tej. Në materialin që do të merrni, do të keni të gjitha çështjet dhe detyrat që do t'u jepen ekspertëve për të ardhur me konkluzione, më pas komisioni do të mblidhet, siç e kemi parashikuar në planin e punës, për të marrë vendime përfundimtare në një fazë tjetër. Por unë do të doja të lista çështjet kryesore që dolën sot nga ky takim.

Çështja e parë që u ngrit është ajo e regjistrimit të kandidatëve, me një seri problematikash që kanë të bëjnë me afatet e regjistrimit, me verifikimin e firmave, me mundësinë e vëzhgimit të firmave, me të drejtën e ankimit në kohën dhe më rregulla për përzgjedhjen e kandidaturave, të cilat mund të jenë më ligj. Sigurisht që ka edhe elemente të tjera, të cilat do të listohen në mënyrë shteruese.

Një çështje që u diskutua gjatë dhe me shumë interes ishte çështja e pjesëmarrjes së grave dhe çështja e kuotave, pra se cili është sistemi; nëse do të mbajmë këtë sistem dhe do të forcojmë efikasitetin e sanksioneve, për ta bërë këtë sistem edhe më të mirë, siç e kemi sot.

Një çështje që doli këtu, ishte pjesëmarrja e minoriteteve në dy aspekte: së pari, aksesin e tyre në procesin zgjedhor. Nuk besoj se këtu shtrohet çështja e kuotave, sepse nuk është as rekomandim, por çështja dhe fakti që këta janë një nga komunitetet më vulnerable për shitje-blerjen e votës që jo vetëm e konfirmon problemin, por është diçka që duhet trajtuar dhe do ta trajtojmë në sesionin tjetër për shitje-blerjen e votës.

Me shumë interes doli këtu edhe çështja e ankimeve dhe apelimeve qoftë të aspektit formal deri në shqyrtimin e ankimeve; roli që kanë palët në proces, pra mund të ketë të tjera përveç subjekteve politike; barra e provës, këtu ishte edhe çështja nëse apelimi i vendimeve administrative në nivel gjyqësor, i shkallës së parë, duhet të ketë një shkallë të dytë. Pra, janë çështja të debatuar edhe më herët, të vendosura edhe më herët nga komisionet e reformës zgjedhore, por mbeten për ridiskutim.

U ngrit çështja e dekriminalizimit të zgjedhjeve, pra jo vetëm zbatimi efektiv i dispozitave aktuale, por edhe shtrirja e tyre për t'i përjashtuar këta lloj elementësh edhe nga fushata; çështja e rolit të policisë; roli i kandidimit të nëpunësve civilë dhe nëpunësve të tjerë të administratës shtetërore në fushatë si kandidatë, nëse duhet të japin dorëheqjen, sa duhet të shtrihet etj.

Dolën edhe elemente të tjera, të cilat kishin të bënin me sistemin zgjedhor, me listat e hapura ose jo, shitja-blerja e votës, të cilat do të jenë tema për seanca të veçanta diskutimi.

Në gjykimin tim, patëm një set të mirë çështjesh dhe nënçështjesh për diskutim, të cilat do t'i shtrohen grupit të ekspertëve që ata të sjellin zgjidhje dhe propozime konkrete, në mënyrë që komisioni të shkojë në fazën e draftimit të çështjeve që kanë dalë sot. Eventualisht ka edhe elemente të tjera, të cilat do të lidhen vetiu me ato që u diskutuan.

Zoti Çuçi, keni fjalën nëse keni diçka për të shtuar.

Bledar Çuçi – Nuk kam gjë tjetër, veçse do të falënderoj të gjithë kolegët për kontributin!

Ndoshta e mirëkuptoj pjesën e parë, pra debatet që bëjnë në lidhje me ecurinë e komisionit, por, meqë ishte hera e parë që kaluam në këtë format, besoj dhe shpresoj të jetë e

kapërcyer. Pra, për çdo çështje të platformës që kemi miratuar do të bëjmë të njëjtën gjë, pra do të bëjmë një tryezë të tillë, ku të ezaurojmë një ballafaqim tekniko-politik. Sigurisht, ne si përfaqësues politik në komision do të japim konsiderata thelbësore në lidhje me çështjen që trajtohet, duke diskutuar dhe duke ballafaquar *viz a viz* komentet e ekspertëve, në mënyrë që pastaj t'i japim detyrën ekspertit të bëjë produktin e parë dhe të vijë përsëri këtu ta miratojë te ky komision. Kështu që i ftoj të gjithë kolegët të ambientohen me këtë sistem që vetë e kemi miratuar, sepse ju siguroj që do të na çojë në produktin më të mirë dhe konsensual të mundshëm që mund të arrijmë në këtë tryezë. Kështu që faleminderit edhe një herë! Falënderoj edhe zonjën Schmidt! Besoj se ai arriti të kompensonte edhe mungesën e Alekseit dhe e ftoj të jetë vazhdimisht në kontakt edhe me ekspertët tanë që do ta marrin detyrën, pasi të zbardhet çdo gjë që u diskutua në këtë tryezë për të bërë propozime për ndryshime ligjore ose joligjore, pra rregullatore, për të adresuar problemet që u ngritën.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA